



Takimet në Prishtinë Udhëheqësit Komunalë dhe Fetarë

Korrik – Tetor 2024

Përgatitur nga:

Instituti Kosovar për Hulumentim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) OJQ AKTIV

Kontakti: Rr. Major Mehmet Bushi, H. III/1,
10 000 Prishtinë, Kosovë.
Tel: +383 (0)38 542 778
Web-site: www.kipred.org
Email: info@kipred.org

Kontakti: Str. Kralja Petra I, 183a, Mitrovica,
Kosovo. Tel: +381 (0) 64 310 6660
Web-site: www.ngoaktiv.org
Email: office@ngoaktiv.org

Përkrahur nga:



Informata në këtë botim është dhënë si pjesë e projektit “Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë,” i zbatuar nga Instituti Kosovar për Hulumentim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) në partneritet me OJQ-në AKTIV dhe i financuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Ky synon ta ofrojë një pasqyrë të rezultateve dhe të diskutimeve nga dialogjet multi-etnike në Prishtinë. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura këtu janë ato të pjesëmarrësve, dhe nuk i pasqyrojnë medoemos politikat dhe qëndrimet zyrtare të KFOS-it.

Parathënie

Nisma e shoqërisë civile “Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë” i përfshin 10 përfaqësues nga komunitetet e shoqërive civile shqiptare dhe serbe, të udhëhequra nga Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) me seli në Prishtinë, dhe OJQ-ja AKTIV, me seli në Mitrovicën e Veriut. Kjo nismë është përkrahur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS).

“Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë” synon ta forcojë dialogun, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin midis komuniteteve të ndryshme etnike dhe fetare, dhe t’i kontribuojë bashkëjetesës ndër-etnike në Kosovë.

Një aspekt i veçantë i kësaj nisme janë “Letrat e Dëshirave dhe të Pritjeve,” të shkruara nga pjesëmarrësit e Karvanit. Këto letra i shprehin shpresat dhe vizionet e tyre për bashkëjetesë dhe respektim të ndërsjellë midis grupeve të ndryshme etnike. Këto shërbejnë si një bazë për diskutimet tona me kryetarët e komunave dhe me udhëheqësit fetarë, dhe po ashtu i përfshijnë edhe sugjerimet për përmirësimin e marrëdhënieve dhe për bashkëjetesën midis komuniteteve etnike.

Ju ftojme t’i përkrahni qëllimet e kësaj nisme për forcimin e themeleve dhe ndërtimin e një shoqërie multi-etnike, demokratike dhe liberale në Kosovë.

Lulzim Peci
Drejtor Ekzekutiv
KIPRED

Miodrag Miličević
Drejtor Ekzekutiv
NGO AKTIV

Përmbajtja:

I. Hyrje.....	3
Pikat kyçe nga takimi me Kryetarin e Komunës së Prishtinës	5
Pikat kyçe nga takimet me udhëheqësit fetarë	7
II. Përfundimet dhe Përkushtimet për Veprimet e Ardhshme	10
III. Letrat e Pritjeve dhe të Dëshirave	13
Z. Përparim Rama, Kryetar i Komunës së Prishtinës.....	12
Z. Naim ef. Tërnavë, Myfti i Kosovës	24
SH.T. Monsinjon Dodë Gjergji, Peshkop i Peshkopatës së Kosovës	35
I Përnderuari Kryepriifti Staniša Arsić, Kisha Ortodokse Serbe e Shën Nikollës	46
Z. Artur Krasniqi, Pastor, Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës	57

I. Hyrje

“Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë” është një nismë risimtare e shoqërisë civile e zbatuar nga Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED) dhe OJQ-ja AKTIV, që përkrahet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Me selitë operacionale në Prishtinë dhe në Mitrovicën e Veriut, këto organizata e kanë udhëhequr një grup prej dhjetë përfaqësuesish, si nga komuniteti shqiptar, ashtu edhe nga ai serb.

“Karvani Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë” synon t’i adresojë tendosjet ndëretnike të rrënjosura thellë në Kosovë, dhe atë kryesisht ato midis komunitetit shqiptar dhe atij serb, që kanë vazhduar për shkak të konflikteve historike, sfidave politike, dhe dallimeve kulturore e fetare. Këto tendosje i kanë penguar përpjekjet drejt pajtimit dhe bashkëjetesës, dhe janë përkeqësuar nga mundësitë e kufizuara për ndonjë dialog dhe ndërveprim domethënës midis komuniteteve. Qëllimi kryesor i projektit është ta forcojë një mjedis të qëndrueshëm të mirëkuptimit, respektimit, dhe bashkëpunimit të ndërsjellë midis komuniteteve shqiptare dhe serbe në Kosovë, përmes një dialogu risimtar dhe strategjive të angazhimit aktiv.

Për ta arritur këtë, projekti e ka caktuar një grumbull detyrash të veçanta, duke përfshirë:

1. Promovimin e Dialogut Ndëretnik: Ngritja e platformave të reja për dialog midis komuniteteve, që e shfrytëzojnë bashkëpunimin midis OJQ-ve, autoriteteve komunale, dhe udhëheqësive fetare për t’i tejkaluar ndarjet dhe për ta kultivuar multietnicitetin.
2. Forcimi i Mirëkuptimit Ndëretnik: Rritja e besimit dhe e dashamirësisë së ndërsjellë midis komuniteteve duke u përballur me stereotipet dhe keqkuptimet, dhe duke e promovuar respektimin dhe vullnetin e mirë.
3. Të Ndihmuarit e Bashkëpunimit: Inkurajimi i nismave të përbashkëta dhe i veprimtarive bashkëpunuese ndërmjet oganizatave të shoqërisë civile, qeverisjeve lokale, dhe udhëheqësve fetarë përmes vijave etnike për të punuar drejt qëllimeve të përbashkëta për përmirësimin e gjendjes së komuniteteve dhe për ndryshimin shoqëror në Kosovë.

Përmes përmbylljes së këtyre qëllimeve, projekti përpiqet, jo vetëm t’i zbusë tendosjet e tashme, por edhe t’i shtrojë themelet për një shoqëri paqësore dhe kohezive multi-etnike, duke i kontribuar qëllimit më të gjerë të paqes dhe të stabilitetit në rajon si dhe integriteteve evropiane.

Si vend-ndalja e parë e udhëtimit të Karvanit, kryeqyteti i Kosovës, Prishtina, anëtarëve të tij ua dha mundësinë për anëtarët e tij për të punuar me udhëheqës komunalë dhe fetarë me ndikim. Këta e përfshinin Kryetarin e Komunës, Përparim Ramën, Imamin e Madh të Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahitin, Peshkopin Dodë Gjergjin të Peshkopatës së Kosovës, Kryepriftin Staniša Arsić të Kishës Ortodokse të Shën Nikollës, dhe Kreun e Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës, Pastorin Artur Krasniqin. Takimet u mbajtën më 30 korrik dhe 15 gusht 2024. Takimi me Kryepriftin Arsić është në pritje të miratimit zyrtar nga Dioqeza e Rashkës dhe e Prizrenit. Ky raport do të plotësohet një herë pasi që të ndodhë ky takim.

Qendrore në këtë ndërmarrje janë “Letrat e Dëshirave dhe të Pritjeve,” që janë përpiluar me kujdes nga pjesëmarrësit e Karvanit. Këto letra janë më shumë se thjesht formalitete; ato i mishërojnë shpresat dhe vizionet e sinqerta të autorëve të tyre për një të ardhme ku grupet e ndryshme etnike jetojnë bashkë në paqe dhe respektim. Letrat janë themelore për procesin e dialogut, duke i udhëhequr diskutimet me kryetarët e komunave dhe me udhëheqësit fetarë. Këto përmbajnë

sugjerime të menduara thellë që e synojnë përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe ndihmesën e bashkëjetesës së përditshme midis komuniteteve.

Para takimeve, të gjithë anëtarët e Karvanit i shkruan këto “Letra të dëshirave dhe të pritjeve” për bashkëbiseduesit kyç në Prishtinë: Kryetarin të Komunës së Prishtinës, Përparim Ramës, Kreut të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnavës, Peshkopit të Dioqezës Prizren-Prishtinë, SH.T. Imzot Dodë Gjergjit, Kreut të Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës, Pastorit Artur Krasniqit, dhe Administruesit të Kishës Ortodokse Serbe të Shën Nikollës në Prishtinë, Kryepriiftit Staniša Arsić.

Teksti në vijim përqendrohet në përfundimet kyçe që u nxorën nga këto diskutime të rëndësishme, si dhe në letrat që i shprehin aspiratat dhe pritjet e shprehura nga anëtarët e Karvanit.

Çështjet kyçe nga takimi me Kryetarin e Komunës së Prishtinës

Takimi me Kryetarin e Komunës Përparim Ramën – Komuna e Prishtinës, 15 gusht, 2024.

Përmes letrave të dëshirave dhe të pritjeve, anëtarët e Karvanit e shprehën dëshirën e tyre për një rol më të madh të komunës së Prishtinës në përparimin e multi-etnicitetit dhe të tolerancës, dhe parashtruan propozime konkrete për shqyrtim:

Propozimet kyçe nga letrat e dëshirave dhe të pritjeve që iu adresuan Kryetarit ishin:

- Ngjarjet si tregjet e përbashkëta (ku banorët e periferisë dhe të rrethinës do të ftoheshin për t’i ekspozuar dhe shitur produktet e tyre), e deri te festivalet kulturore, turnetë sportive dhe kremtimet publike, mund të krijojnë mundësi për banorët për t’u lidhur, për t’i kremtuar traditat e njëri-tjetrit me njëri-tjetrin dhe për të bërë shokë.
- Duke qenë pjesë e Sunny Hill Festival, komuna e Prishtinës mund ta promovojë festivalin në komunat me shumicë-serbe dhe t’i ftojë dhe t’u ofrojë mundësi falas komunitetit serb për të marrë pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme për të rinjtë.
- Angazhimi me komunitetet jo-shumicë, adresimi i shqetësimeve të tyre, sigurimi i përfaqësimit të tyre në qeverisjen lokale dhe mundësimi i kthimit të serbëve të Kosovës.
- Organizimi i ngjarjeve që theksojnë trashëgiminë e shumëllojshme të Prishtinës, inkurajimi i programeve që promovojnë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin midis studentëve të prapavijave të ndryshme, dhe sigurimi aktiv i asaj që të gjitha grupet etnike të ndjehen të përfaqësuara në administratën e Prishtinës mund të jetë i rëndësishëm.
- Angazhimi aktiv në ndërtimin e komunitetit paqësor dhe përfshirës duke përkrahur nisma ndër-etnike, duke promovuar politika që sigurojnë mundësi të barabarta për të gjithë dhe duke inkurajuar dialogun e hapur dhe me respektim midis grupeve të ndryshme etnike.
- Themelimi i një forumi të përhershëm me përfaqësuesit e popullatës në Bërnice ku do të diskutoheshin dhe adresoheshin çështjet e hapura në fushën e qeverisjes. Themelimi i një këshilli për dialogun ndër-fetar me përfaqësuesit e Komunitetit Islamik, ata të Kishës Katolike, të Kishës Protestante, dhe të Kishës Ortodokse Serbe. Nisma Prishtina Qytet i Hapur për të Gjithë, si një aksion do ta përfshinte një vizion për një kryeqytet paqësor dhe përfshirës.
- Shfrytëzimi i mundësive të ofruara për ta theksuar multietnicitetin si vlerë është jashtëzakonisht i dobishëm. Kjo mund të përfshijë njoftimet e përbashkëta për shtyp apo për mediat sociale në gjuhët e komuniteteve, për shembull, në rastet e ditëve të tyre

kombëtare, apo në kremtimet fetare. Kjo mund të përfshijë po ashtu edhe vizita të botuara në qendrat e komuniteteve në komunë, të tilla si qendra e komunitetit serb afër Kishës Ortodokse Serbe në Prishtinë, qendrat boshnjake në Prishtinë, apo vendet e ngjashme për komunitetin rom. Inkurajimi i bashkekzistencës paqësore dhe i multietnicitetit, si dhe deklaratat e përbashkëta lidhur me këto vizita, do të jenë tepër të mirëseardhura.

- Ndërmarrja e nismës për projektet e përbashkëta ndërkomunale të udhëhequra nga Prishtina dhe të zbatuara nga komunat e përzgjedhura multietnike, të tilla si Graçanica, Kamenica, apo Shtërpca.
- Organizimi i ngjarjeve në shkollat fillore dhe të mesme të Prishtinës që i nënvizojnë kulturat, ushqimet dhe traditat e ndryshme, mund ta rrisë ndjenjën e unitetit. Mësimdhënësit mund të fuqizohen për t'i hetuar temat e barazisë, të tolerancës, dhe të pranimit përmes artit dhe veprimtarive në klasë. Krijimi i klubeve aktive të debateve në shkollat mund ta ndihmojë mësimin e mendimit kritik dhe t'u mundësojnë studentëve që t'i kuptojnë perspektivat e ndryshme.
- Organizimi i vizitave kulturore për studentët për ta përjetuar pasurinë e Kosovës, dhe krijimi i "Këshillit për Bashkekzistencë" me përfaqësuesit e grupeve të ndryshme etnike mund të jetë një hap i rëndësishëm dhe transformues drejt këtij qëllimi dhe diversitetit.
- Komuna e Prishtinës mund ta caktojë një Ditë vjetore të Multietnicitetit, në ndonjë datë gjatë vitit, në të cilën në sheshin e Prishtinës do të organizohet një takim i qytetarëve i të gjitha komuniteteve etnike, dhe posaçërisht i shqiptarëve dhe serbëve, gjë kjo që do të vijohet nga një Marsh Multietnik përmes qytetit, dhe vizita e tyre e përbashkët në kafiteritë dhe restaurantet e Prishtinës.

Gjatë takimit, anëtarët e Karvanit i shprehën shqetësimet për rritjen e tensioneve etnike në Kosovë dhe për trajektoren e vendit, posaçërisht sa i përket kohezionit shoqëror dhe pamjes së tij ndërkombëtare. Ata propozuan një varietet aktivitetesh për t'i bërë bashkë të gjitha grupet etnike, të tilla si ngjarje kulturore, artistike, muzikore dhe sportive, për ta bërë çdo grup që të ndjehet i integruar brenda kryeqytetit. Ata e theksuan rëndësinë e asaj që Prishtina t'i vlerësojë nevojat e të gjithë qytetarëve të vet, dhe posaçërisht të të rinjve, për t'i familiarizuar ata më mirë me kryeqytetin. Për shembull, ata e theksuan që Festivali Sunny Hill është relativisht i panjohur për rininë serbe në Graçanicën fqinje, duke sugjeruar që një promovim më efektiv i ngjarjeve të tilla mund ta ndihmojë bashkimin e rinisë.

Anëtarët kërkuan nga Kryetari Rama të jetë më i zëshëm në promovimin e multietnicitetit dhe sugjeruan përvetësimin e motos "Ne jemi bashkë," për ta forcuar mesazhin publik të unitetit. Ata e theksuan rëndësinë e bërjes së këtij mesazhi të qartë për të gjithë qytetarët dhe sugjeruan se ndërsa komunitetet fetare rëndom i mbajnë format më private të bashkëpunimit, Kryetari i Komunës duhet të avokojë për harmoninë multietnike për ta vendosur një shembull pozitiv. Për këtë, ata e rekomanduan shtimin e bashkëpunimit me komunat e tjera për ta rritur solidaritetin rajonal.

Kryetari Rama i detajoi veprimtaritë e ndryshme që tashmë janë duke u ndërmarrur nga komuna për ta forcuar një mjedis multikulturor, duke i shmangur qëllimshëm temat politike përçarëse. Ai u përqëndrua në vendtakimet si Qendra Barabar dhe Bridge Factory, që janë projektuar po ashtu edhe për ngjarjet multietnike. Ai e rikujtoi Manifesta Biennale në Prishtinë, të hapur për të gjithë, e të cilat, fatkeqësisht, nuk e morën përgjigjen nga komuna e Graçanicës dhe nga Kisha Ortodokse, edhe përkundrejt përpjekjeve për të kontaktuar. Ai po ashtu e përmendi takimin e kohëve të fundit me Kishën Ortodokse në Prishtinë lidhur me çështjet e parkimit dhe e shprehi shpresën për takimet e ardhshme bashkëpunuese. Kryetari Rama i diskutoi nismat e reja, përfshirë "Tryezat e Rrumbullakëta," një hapësirë e propozuar artistike kjo ku njerëzit e të gjitha prapavijave etnike të ndikuar nga lufta mund t'i ndajnë përvojat e tyre. Ai po ashtu foli për "Kalabria Cite," një projekt i

ardhshëm ky që synon ofrimin e hapësirës për të gjitha komunitetet fetare, përfshirë komunitetin ortodoks, duke siguruar që çdokush ta ketë një vend për ta zhvilluar harmoninë fetare.

Takimi përfundoi me një vërejtje pozitive, ku Kryetari i Komunës Rama përsëriti përkushtimin e tij për përkrahjen e këtyre nismave. Ai e konfirmoi gatishmërinë e tij për t'i ndihmuar shoqërisë civile dhe për të bashkëpunuar me të, duke deklaruar, "Unë jam i gatshëm të ndihmoj, dhe më konsideroni si një partner." Kjo deklaratë e nënvizoi përkushtimin e tij për promovimin e paqes dhe të bashkëjetesës në Kosovë.

Çështjet kyçe nga takimet me udhëheqësit fetarë

Mesazhet kyçe nga letrat e pritjeve dhe të dëshirave të adresuara për udhëheqësit fetarë u përqendruan nëpër vijat e avokimit të mëtutjeshëm të mirëkuptimit dhe të bashkekzistencës midis komuniteteve etnike, përfshirë këtu edhe veprimtaritë e përbashkëta. Propozimet kyçe në letrat e dërguara ishin si në vijim:

- Përmes transmetimit të mesazheve të tolerancës dhe të paqes, duke i inkurajuar besimtarët që t'i pranojnë këto si vlera të rëndësishme për bashkekzistencën, programet e nismave të përbashkëta humanitare dhe të shërbimit në komunitet mund të ndihmojnë në tejkalimin e ndasive dhe në forcimin e solidaritetit midis komuniteteve shqiptare dhe serbe.
- Përkrahja e programeve të komunitetit dhe projekteve të shërbimit të përbashkët që i bëjnë bashkë njerëzit nga prapavijat e ndryshme, ndërsa predikimet dhe fjalimet publike mund t'i theksojnë unitetin, tolerancën dhe respektimin e të gjithëve.
- Dhënia e deklarimeve publike që i dënojnë aktet e jotolerancës dhe e promovojnë bashkëpunimin ndër-fetar do ta dërgonte një mesazh të fuqishëm të unitetit dhe do t'i frymëzonte të tjerët për ta vazhduar procesin më tutje.
- Themelimi i programeve të qëndrueshme që e promovojnë edukimin për diversitetin kulturor, që i përkrahin projektet e përbashkëta të komunitetit dhe e sigurojnë përfaqësimin e barabartë të të gjitha grupeve etnike dhe fetare në qeverisjen lokale, angazhimi aktiv në ndërtimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës duke i përkrahur nismat ndër-etnike, duke i promovuar politikatat që i sigurojnë mundësitë e barabarta për të gjithë, dhe inkurajimi i një dialogu të hapur dhe me respektim midis grupeve të ndryshme etnike dhe fetare.
- Shqyrtimi i nisjes së dialogut ndër-fetar në nivelin komunal lokal për ta filluar krijimin e një kulture të paqes. Vizitat te udhëheqësit lokalë fetarë ortodoksë serbë do ta kishin një ndikim domethënës në përparimin e bashkekzistencës ndëretnike në vendin tonë. Shqyrtimi i organizimit të vizitave autoriteteve dhe institucioneve fetare të Kishës Ortodokse Serbe në rastin e festave të tyre fetare.
- Ndërmarrja e nismave për ta themeluar një këshill ndër-fetar i cili do t'i koordinonte dhe këshillonte donatorët shtetërorë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen dhe rehabilitimin e objekteve të cënueshme fetare anembanë Kosovës.
- Takimet e rregullta të të gjithë udhëheqësve fetarë në Kosovë për ta promovuar dialogun dhe bashkëpunimin. Këto takime mund të rezultojnë në deklarata dhe nisma të përbashkëta që e promovojnë unitetin dhe mirëkuptimin.

Takimi me Z. Vedat ef. Sahitin, Krueimam i Bashkësisë Islame të Kosovës – 30 korrik, 2024.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile e nënvizuan polarizimin midis grupeve etnike në Kosovë për shkak të pakënaqësive historike dhe klimës aktuale politike. Ata e theksuan rëndësinë e udhëheqësve fetarë në promovimin e paqes dhe të bashkëjetesës.

Z. Sahiti, duke e përfaqësuar komunitetin më të madh fetar në Kosovë, i theksoi përpjekjet në rrjedhje e sipër të Bashkësisë Islame për forcimin e pajtimit, dhe posaçërisht midis rinisë islamike dhe asaj ortodokse, të përkrahur përmes nismave të OSCE-së. Ai i përmendi përfshirjet e Bashkësisë Islame në nismat e ndryshme që e synonin promovimin e mirëkuptimit dhe të unitetit. Këto kanë përfshirë vizitat kulturore, shkëmbimet e studentëve, dhe pjesëmarrjen e rregullt në dialogun ndër-fetar. Ai e theksoi angazhimin e tyre në shtrirjen edukative, duke i përmendur në veçanti tryezat e përbashkëta të rrumbullakëta për studentët e Medresesë dhe të Bogoslllovisë, me qëllim të mësimin për kulturat e njëri-tjetrit dhe për forcimin e mirëkuptimit të ndërsjellë. Ai i nënvizoi marrëdhëniet e mira të komunitetit me të gjitha grupet fetare, dhe posaçërisht dinamikën e përmirësuar me Kishën Ortodokse Serbe.

Gjatë takimit, përfaqësuesit e shoqërisë civile i paraqitën 10 “Letrat e Dëshirave dhe të Pritjeve” të shkruara nga personalitete të shquara të komunitetit, që z. Vedati i pranoi pozitivisht. Ai e shprehu synimin e vet që t’i lexojë ato dhe t’i kuptojë vlerat që i sjellin këto këndvështrime për promovimin e mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit ndër-etnik.

Ai e shprehu brengosjen për pengesat politike dhe rolin destruktiv të mediave në forcimin e perceptimeve negative, duke theksuar përpjekjet për të punuar me partnerët nga mediat për përhapjen e mesazheve pozitive.

Takimi përfundoi në mënyrë pozitive dhe bashkëpunuese, me përkushtimin për t’i vazhduar këto dialogje dhe projekte për përmirësimin e marrëdhënieve ndër-etnike. Qasja e hapur e z. Vedatit dhe qëndrimi proaktiv i shoqërisë civile e nënvizojnë përkushtimin e përbashkët për ndërtimin e një Kosove paqësore dhe përfshirëse.

Takimi me Peshkopin Dodë Gjergji – Katedralja Katolike “Nënë Tereza” në Prishtinë.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile diskutuan për marrëdhëniet e tendosura ndëretnike në Kosovë, duke e theksuar polarizimin për shkak të pakënaqësive historike dhe klimës së tashme politike. Ata e theksuan nevojën urgjente për mesazhet që e promovojnë pajtimin dhe paqen dhe i nxitën udhëheqësit fetarë për t’i përkrahur në mënyrë aktive këto parime.

Peshkopi Gjergji e konfirmoi përkushtimin e Kishës Katolike për pajtim dhe ndërtim të paqes, duke e ruajtur neutralitetin sa i përket ndikimeve politike. Ai e adresoi pengesën kryesore: mungesën e komunikimit me Kishën Ortodokse Serbe, që e pengon unitetin më të gjerë fetar. Edhe përkundrejt kësaj, ai mbetet i hapur për angazhim, duke e rikujtuar një nismë të dështuar ku ai propozoi grumbullimin e të gjitha komuniteteve fetare në Urën e Mitrovicës për ta simbolizuar unitetin. Peshkopi reflektoi për rolin e kishës në përkrahjen e komuniteteve të marginalizuara duke theksuar përkushtimin e qëndrueshëm për t’i ndihmuar ata që kanë nevojë. Ai u zotua për ta vazhduar promovimin e bashkëjetesës, paqes, dhe pajtimit përmes komuniteteve.

Përfaqësuesit ia paraqitën 10 “Letrat e Dëshirave dhe të Pritjeve” të shkruara nga figura të shquara të komuniteteve, të cilat Peshkopi Gjergji i pranoi në mënyrë pozitive, duke e shprehur qëllimin e tij për t’u përgjigjur me shkrim. Këto letra thërrisnin për përpjekje të qëndrueshme për forcimin e një Kosove multietnike ku mbizotëron bashkekzistenca paqësore.

Takimi përfundoi me një vërejtje optimiste dhe bashkëpunuese, ku të gjitha palët janë përkushtuar për më shumë takime në të ardhmen, për më shumë projekte bashkëpunuese dhe ngjarje të komuniteteve që synojnë rritjen e marrëdhënieve ndër-etnike. Përfaqësuesit e shoqërisë civile e përforcuan përkrahjen e tyre për udhëheqjen e Peshkopit në këto përpjekje, duke besuar plotësisht në atë që pajtimi dhe paqja janë qëllime të arritshme.

Takimi me Pastor Artur Krasniqin, Drejtues i Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës, 30 korrik, 2024.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile i ngritën shqetësimet e tyre lidhur me tendosjet gjithnjë e më të mëdha midis grupeve etnike në Kosovë, dhe me atë që të drejtat njerëzore të pjestarëve të etnisë serbe janë duke u shkelur.

Pastor Krasniqi tha se Kosova ka luftuar për ta promovuar paqen në mënyrë efektive. Ai vërejti se Kisha Protestante Ungjillore i mban marrëdhëniet e mira me të gjitha komunitetet fetare. Pastor Krasniqi theksoi se ngritja e nacionalizmit në të dyja anët është një pengesë e rëndësishme për paqen. Ai po ashtu i shprehu shqetësimet për mungesën e njohjes legale për komunitetet protestante dhe të tjera në Kosovë, duke thënë se qeveria ka shfaqur fare pak gatishmëri për ta miratuar legjislacionin e duhur. Kjo mungesë e përkrahjes legale, vërejti ai, komunitetet fetare i lë që të veprojnë në një situatë të pasigurisë.

Ai shprehu pritjet e tij se qeveria e Kosovës nuk do ta anashkalojë edhe më tutje detyrën e vet për t'i bërë komunitetet fetare bashkë, duke sugjeruar që kjo shpërfillje i acaroi ndasitë. Edhe përkundëjt madhësisë së vogël të komunitetit protestant, ai theksoi pjesëmarrjen e përbashkët në konferencat me pastorët protestantë serbë. Ai përkujtoi rastin ku e organizoi një konferencë në Prishtinë që u ndoq nga pastorët nga Serbia që e promovonin pajtimin.

Edhe përkundëjt këtyre sfidave, Pastori Krasniqi mori përsipër t'i lexojë 10 "Letrat e Dëshirave dhe të Pritjeve" që iu paraqitën nga përfaqësuesit e shoqërisë civile. Ai konfirmoi sërish përkushtimin e tij për t'i vazhduar përpjekjet për ta promovuar paqen dhe bashkëjetesën në Kosovë.

Takimi përfundoi me njohjen e pengesave por edhe me përkushtimin e përbashkët midis pjesëmarrësve të tij për t'u përpjekur për paqe dhe unitet të Kosovës. Angazhimi i Pastor Krasniqit në dialog dhe në kontaktet e komunitetit thekson përpjekjen në rrjedhje e sipër për t'i tejkaluar ndasitë dhe për ta forcuar një shoqëri më përfshirëse.

Takimi me Kryepriiftin Staniša Arsić në Kishën Ortodokse në Prishtinë, 18 tetor 2024.

Ky dialog i fokusuar me Kryepriiftin Staniša Arsić i shqyrtoi sfidat dhe mundësitë domethënëse për bashkëpunimin ndër-fetar në Prishtinë. Diskutimi u përqendrua në disa çështje operationale me të cilat përballet Kisha Ortodokse, të tilla si sfidat e menaxhimit të pronës dhe të parkingut.

Një shqetësim i madh që u diskutua ishin shërbimet jo të mjaftueshme komunale, dhe posaçërisht ndriçimi i pamjaftueshëm i rrugës përreth objekteve të kishës, i cili, jo vetëm që paraqet rrezik për sigurinë, por po ashtu edhe e tregon mospërfilljen nga autoritetet lokale – një kontrast i plotë ky ndaj përkrahjes që e marrin institucionet e tjer fetare.

Biseda po ashtu e hetoi edhe përparimin e ngadalshëm në rivendosjen e të drejtave pronësore që historikisht janë lidhur me komunitetin ortodoks, ku Kryepifti Arsić e theksoi nevojën për mbrojtje dhe përkrahje më të fuqishme ligjore për t'i adresuar këto ankesa të kahmotsme.

Edhe përkundrejt këtyre sfidave, Kryepriifti Arsić i nënvizoi marrëdhëniet pozitive ndërfitare përbrenda komunitetit duke i rrëfyer rastet e suksesshme të bashkëpunimit me udhëheqësit nga komunitetet myslimane dhe katolike. Ky bashkëpunim e ka forcuar një frymë të respektit dhe miqësisë midis grupeve fetare të ndryshme.

Ai e dha një dëshmi prekëse rreth fuqisë së përpjekjeve kolektive: “Vetëm përmes përpjekjeve tona të përbashkëta dhe mirëkuptimit të ndërsjellë ne mund t’i tejkalojmë sfidat me të cilat po përballet komuniteti jonë,” duke theksuar optimizmin dhe përkushtimin e tij për forcimin e harmonisë komunale.

Takimi përfundoi ashtu që Kryepriifti Arsić e shprehi përkrahjen e fuqishme për Karvanin dhe një përkushtim të përbashkët për rritjen e bashkëpunimit që e synon forcimin e bashkekzistencës ndërretnike dhe ndërfitare midis komuniteteve të ndryshme në komunë.

Ky takim e theksoi një rikonfirmim të qëllimeve të përbashkëta të paqes dhe të bashkëpunimit brenda komuniteteve të ndryshme fetare të Prishtinës, duke ia dhënë një ngjyrim shpresëdhënës përpjekjeve të ardhshme për forcimin e lidhjeve të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit.

II. Përfundimet dhe Përkushtimet për Veprimet e Ardhshme

Nisma e “Karvanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkekzistencë” e ndihmoi me sukses një varg dialogesh shumë të rëndësishme në Prishtinë, duke çuar në përkushtime të rëndësishme për rritjen e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërretnik nga ana e udhëheqësve kyç të komuniteteve. Përpjekjet kolektive të paraqitura gjatë këtyre dialogjeve nënvizojnë një përkushtim të fuqishëm për t’u përballur me sfidat dhe për të kapitalizuar nga mundësitë për kultivimin e një shoqërie harmonike multi-etnike në Kosovë.

Përkushtimet Strategjike nga Udhëheqësit Fetarë: Diskutimet me personalitetet e shquara fetare, të tilla si Peshkopi Dodë Gjergji, Imami i Madh Vedat ef. Sahiti, Pastori Artur Krasniqi, dhe Kryepriifti Staniša Arsić, kanë theksuar rolin jetik që komunitetet fetare e luajnë në forcimin e paqes dhe të unitetit. Udhëheqësit fetarë u zotuan që:

- Të nisin dhe të mbajnë platforma të dialogut ndërfitar që i adresojnë tendosjet ekzistuese dhe që promovojnë marrëdhënie të qëndrueshme midis grupeve të ndryshme fetare.
- T’i ndihmojnë dhe përkrahin nismat e përqendruara në komunitetet që e theksojnë rëndësinë e respektimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë, duke forcuar përkushtimin thelbësor ndaj paqes dhe bashkëjetesës.

Roli i Udhëheqësisë Komunale në Rritjen e Kohezionit të Komunitetit: Bisedimet e Kryetarit të Komunës Përparim Ramës e kanë ndriçuar rolin kyç të komunës në zhvillimin e një mjedisi urban përfshirës. Përkushtimet e tij përfshijnë:

- Zbatimin e politikave dhe të nismave që e forcojnë në mënyrë aktive diversitetin kulturor dhe angazhimin ndërfitar, të tilla si festivalet multikulturore dhe kremtimet publike përfshirëse.
- Promovimi i përfshirjes aktive të komuniteteve jo-shumicë në proceset e planifikimit komunal, për të siguruar vendim-marrje përfshirëse dhe përfaqësimin në zhvillimin e qytetit.

Veprimet Bashkëpunuese për një Ndryshim të Qëndrueshëm: Një përkushtim i përbashkët për ritrajtësimin e marrëdhënieve ndëretnike të Kosovës ishte evident gjatë të gjitha diskutimeve. Strategjitë parësore të identifikuara përfshijnë:

- Themelimin e “Këshillit për Bashkekzistencë”: Ky organ do t’i mbikëqyrë dhe integrojë nismat ndëretnike në veprimtaritë e komuniteteve dhe politikat qeveritare, duke forcuar përfshirjen afatgjatë.
- Krijimi i Këshillit Ndërfetar: Duke punuar në partneritet me qeverinë dhe me organizatat ndërkombëtare, ky Këshill do të përqendrohet në mbrojtjen dhe nderimin e vendeve dhe objekteve fetare, duke promovuar trashëgiminë e përbashkët kulturore dhe rritjen e respektimit të ndërsjellë.
- Rregullarizimi i Dialogjeve: Planifikimi i takimeve të qëndrueshme midis udhëheqësve fetarë dhe qytetarë për ta mbajtur komunikimin e hapur, për t’i zbatuar nismat e përbashkëta, dhe për ta siguruar një qeverisje të përgjegjshme ndaj nevojave dhe aspiratave të ndryshme të të gjithë anëtarëve të komunitetit.

Takimet në Prishtinë: Kryetari i Komunës dhe Liderët Fetarë



Takimi me z. Përparim Rama,
Kryetar i Komunës së Prishtinës
14 gusht 2024



Takimi me z.Vedat ef. Sahiti,
Imami i Madh i Bashkësisë Islame të Kosovës
30 korrik 2024



Takimi me SH.T. Imzot Dodë Gjergji, Ipeshkëv
Administrator Apostolik i Kosovës
30 korrik 2024



Takimi me Kryepriiftin Arsić
Kisha Ortodokse Serbe e Shën Nikollës
18 tetor 2024



Takimi me Pastor Artur Krasniqi
Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës
30 korrik 2024



Letrat e Dëshirave dhe Pritjeve

Leonora Kryeziu, Jovana Radosavljević, Robert Muharremi, Dušan Radaković, Ilir Deda, Senad Sabović, Ramadan Ilazi, Dimitrije Obrenović, Mentor Agani dhe Zoran Savić

z. Përparim Rama
Kryetar i Komunës së Prishtinës

Korrik 2024

**Leonora Kryeziu, Drejtoreshë Ekzekutive
Instituti i Prishtinës për Studime Politike
Prishtinë, Kosovë**

I nderuari Kryetar Rama,

Unë jam Leonora Kryeziu, banore e Prishtinës e lindur në vitin 1971. Duke qenë se i takoj një gjenerate që fëmijërinë dhe rininë e kam kaluar në ish-Jugosllavi, mbaj mend mirë se si dukej bashkëjetesa multi-etnike në Prishtinë, me ngjyrimet e veta sa të errëta, po aq edhe të bukura, të një bashkëjetese deri diku të qetë.

E rritur në zemër të Prishtinës, shtëpia ime ndodhej në një lagje të populluar nga fqinjë serbë, me të cilët, përkundër mos shoqërimit të ngushtë, kishim një kohabimit të përbashkët në shkolla, në vende të punës, dhe në sferën e kulturës. Kjo e fundit ishte mbase pika e përbashkët e takimit që prodhonte më së shumti bashkëpunim, pasi që muzika, sporti dhe kultura ushqenin ndjesinë e përkatësisë në atë kohë.

Me këtë letër, dua të ndaj me ju pritjet dhe dëshirat e mia personale lidhur me promovimin e kohezionit social midis komunitetit shqiptar dhe atij serb në kryeqytet dhe jo vetëm duke përmendur shembuj të së kaluarës por edhe mundësitë që na i ofron e tashmja. Politika është mjeti më i fuqishëm në duart e një lideri për të ndikuar në jetët e njerëzve, në ndërtimin e urave të komunikimit ashtu edhe në shkatërrimin e tyre, andaj besoj se sot ju keni mundësi për të trasuar rrugën për një kohezion më të madh social si në komunën tonë ashtu edhe në nivelin nacional.

Çfarë është sot kryeqyteti ynë dhe a mund të bëjmë më shumë për t'ja kthyer sado pak natyrën gjithëpërfshirëse, ku çdo qytetar i saj, shqiptar dhe serb, do ta ndjejë qytetin si të vetin? Sot, Prishtinën nuk e banojnë qytetarët e dikurshëm serbë të Kosovës. Shkollat e Prishtinës janë monoetnike, spitalet janë të mbushura dhe vizitohen nga të gjithë të tjerët pos popullatës serbe. Arsytet i dimë të gjithë, por sot dua të sfidojemi dhe të mendojmë se a mund të bëjmë më shumë, a mund t'ja rikthejmë Prishtinën atyre qytetarëve të komunitetit serb të cilët duan ta përjetojnë dhe ndjejnë si vendin e tyre, vendin ku kanë kaluar fëmijërinë dhe janë shkolluar, ku ata mund të ndjehen të sigurtë dhe të dëshiruar, ku fëmijët e tyre mund t'i ndajnë hapësirat shkollore të përbashkëta, ku spitalet tona do të jenë adresa e parë e tyre, që të mos na përsëriten rastet e dhimbshme sikur ai i vajzës 15 vjeçe e cila humbi jetën pasi që spitali i Prishtinës nuk bënte të vizitohej. Unë besoj se kryeqyteti ka mundësi dhe do të duhej të punonte për një të ardhme më të pasur në çdo aspekt.

Çfarë mund të bëjë qyteti për qytetarët e vet derisa politika merret me vendimet e mëdha?

Së pari, besoj se organizimi dhe ofrimi i ngjarjeve të përbashkëta në komunitet mund ta luajë një rol vendimtar në afrimin e njerëzve, barrierat thyhen edhe në heshtje. Ngjarjet si tregu i përbashkët (ku do të ftoheshin banorët e rrethinës së Prishtinës që t'i ekspozojnë dhe shesin produktet e tyre) e deri tek festivalet kulturore, turnetë sportive dhe festimet publike mund të krijojnë mundësi që banorët të lidhen, të festojnë traditat e njëri-tjetrit dhe të krijojnë miqësi. Unë dëshiroj një të ardhme ku këto ngjarje do të bëhen një traditë në Prishtinë apo edhe në komunat tjera, duke simbolizuar identitetin tonë të përbashkët dhe duke nxitur respektin e ndërsjellë midis të gjithë qytetarëve.

Në fillim e përmenda rolin që kishte muzika dhe kultura në të kaluarën. Besoj se Prishtina ka çka të ofrojë në këtë drejtim. Tash e sa vite komuna jonë është nikoqire e festivalit më të madh në rajon, Sunny Hill Festival – i cili i kalon përmasat e vendit dhe rajonit, por që mbetet i largët dhe i paqasshëm për një pjesë të popullatës, të rinjtë nga komuniteti serb në Kosovë. Komuna e

Prishtinës, duke qenë në një mënyrë hisedare në këtë festival, do të mund ta promovonte festivalin në komunat me shumicë serbe dhe t'i ftonte dhe ofronte mundësi falas komunitetit serb që të marrë pjesë në këtë ngjarje aq të rëndësishme për të rinjtë. Asgjë nuk i bashkon njerëzit më mirë se muzika.

Së dyti, organizimet tjera kulturore me karakter bamirësie të cilat organizohen nga shoqëria civile, janë një mundësi e mirë të shfrytëzohen dhe përkrahen nga komuna. Ja vetëm një shembull, nisma e bamirësisë si 'Cycling for Kosovo Children' e cila organizohet çdo vit nga shoqata 'Mother and Child' do të mund të përkrahej nga komuna dhe mjetet e dedikuara të shkonin në përkrahje për fëmijët e komunitetit serb. Së treti, komunat mund të inicojnë vizita apo shkëmbime mes nxënësve shqiptarë dhe serbë, të organizojë turnamente të lojërave online, gara të gjuhës angleze, turnamente sportive të cilat do t'ju japin mundësi të rinjve t'i thyejnë barrierat etnike dhe të njohin njëri-tjetrin përmes ngjarjeve kulturore dhe sportive.

Projektet e përbashkëta të infrastrukturës, si parqet, urat, objektet rekreative dhe qendrat komunitare, mund të shërbejnë gjithashtu si simbole të fuqishme uniteti. Këto hapësira të përbashkëta mund të ofrojnë përfitime të prekshme për të gjithë banorët dhe të demonstrojnë rezultatet pozitive të punës së përbashkët. Unë dua të shoh një të ardhme ku ura mbi lumin Ibër do të shërbejë si hapësirë përbashkuese mes komuniteteve dhe që projekte të tilla do të bëhen pikë referimi të përpjekjeve tona bashkëpunuese.

Projektet e përbashkëta humanitare, të tilla si organizimet e shpërndarjes së ushqimeve, ngjarjet bamirëse dhe mbështetja për popullatat e cenushme, gjithashtu mund t'i afrojnë komunitetet tona. Duke punuar krah për krah në këto projekte, vullnetarët shqiptarë dhe serbë mund të ndërtojnë marrëdhënie dhe të zhvillojnë një ndjenjë solidariteti.

Si përfundim, shpresoj se me udhëheqjen dhe angazhimin tuaj, ne mund të ndërtojmë një të ardhme më përfshirëse dhe më paqësore. Besoj se përmes përpjekjeve të përbashkëta dhe përkushtimit ndaj vlerave të përbashkëta, mund ta krijojmë një qytet ku të gjithë banorët, pavarësisht përkatësisë etnike, do të ndjehen të vlerësuar dhe të respektuar. Në këtë mënyrë, ne mund ta ndërtojmë një shoqëri ku të gjithë jetojnë në harmoni dhe paqe, duke pasur si qëllim të përbashkët zhvillimin e një të ardhmeje më të mirë për brezat e ardhshëm.

Me respekt,

Leonora Kryeziu

Jovana Radosavljević, Drejtoreshë Ekzekutive
New Social Initiative
Mitrovicë e Veriut, Kosovë

I dashuri z. Rama,

Shpresoj që kjo letër t'ju gjejë mirë. Unë quhem Jovana Radosavljević, dhe jam një aktiviste serbe e Kosovës e shoqërisë civile nga Mitrovica e Veriut, që punon në përpjekjet për pajtimin midis serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës. Këtë letër jam duke ju shkruar si pjesë e Karvanit Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë, për t'i ndarë pritjet dhe dëshirat e mia për bashkëjetesë multietnike në Kosovë.

Si Kryetar i Komunës, roli juaj për promovimin e politikave dhe ngjarjeve gjithëpërfshirëse që i lartësojnë kulturat tona të ndryshme është thelbësor. Ju bëj thirrje të angazhoheni me komunitetet joshumicë, t'i adresoni brengat e tyre, ta siguronit përfaqësimin e tyre në qeverisjen lokale dhe ta mundësoni kthimin e serbëve të Kosovës.

Duke shikuar përpara, vizioni im është ai i një Kosove ku bashkëjetesa multietnike është realitet. Në Prishtinë, shpresoj të shoh qendra dhe nisma ndërkulturore që promovojnë dialogun dhe projekte të përbashkëta të komunitetit. Krijimi i një "Këshilli të Bashkëjetesës," me përfaqësues nga grupet e ndryshme etnike, mund të jetë një hap i rëndësishëm drejt këtij qëllimi.

Në përfundim, ju inkurajoj të vazhdoni ta ndërtoni një komunitet paqësor dhe përfshirës. Udhëheqja juaj mund t'i frymëzojë të tjerët për ta ndjekur shembullin, duke krijuar një të ardhme ku në Kosovë të gjithë do të ndjehen si në shtëpinë e vet.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën.

Sinqerisht,

Jovana Radosavljević

Dr. Robert Muharremi
Fred C. Cuny Center for Peace and Conflict Studies
Rochester Institute of Technology in Kosovo
Prishtinë, Kosovë

I dashuri Kryetar Përparim Rama,

Po ju shkruaj sot për t'ju përgëzuar për përkushtimin tuaj për ta udhëhequr Prishtinën si një qytet përplot jetë, modern dhe përfshirës. Qendra Fred C. Cuny për Studime të Paqes dhe të Konfliktëve në Institutin Rochester të Teknologjisë në Kosovë ofron një platformë akademike për studimin dhe mësimin e shkaqeve, të praktikave dhe të pasojave të luftës dhe dhunës politike, si dhe të metodave të menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktëve. Hulmimi jonë ndihmon akademikët, qeveritë, praktikuesit dhe shoqërinë civile për ta kuptuar natyrën e konfliktit dhe për t'i formuluar politikat efektive të zgjidhjes. Qendra jonë është në krye të bashkimit të qendrave kërkimore dhe të organizatave të shoqërisë civile që përfaqësojnë komunitetet e ndryshme të Kosovës dhe nxisin një klimë të mirëkuptimit dhe të tolerancës së ndërsjellë.

Jam duke ju shkruar për ta shprehur mbështetjen e plotë, si timen, ashtu edhe të Qendrës sonë, për nismën e Karvanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë. Kosova është një shoqëri multietnike, demokratike dhe pluraliste, dhe besoj se respektimi i Kushtetutës së Kosovës e cila i mbron këto vlera dhe orientimin euroatlantik të Kosovës, nuk është vetëm kritik, por është edhe vetë thelbi i asaj për të cilën Kosova qëndron.

Në nivelin e qeverisjes lokale, nismat që promovojnë bashkëpunimin ndëretnik dhe tolerancën fetare mund ta kenë një ndikim të thellë. Organizimi i ngjarjeve që e theksojnë trashëgiminë e larmishme të Prishtinës, inkurajimi i programeve që promovojnë mirëkuptimin dhe bashkëpunimin mes studentëve me prejardhje të ndryshme, dhe sigurimi aktiv që të gjitha grupet etnike të ndjehen të përfaqësuara në administratën e Prishtinës mund të jenë domethënëse. Duke ndërmarrë hapa të tillë, ju do ta dërgoni një mesazh të fuqishëm të unitetit, të përfshirjes dhe të lidhshirësisë në përputhje me vlerat kushtetuese të Kosovës.

Shpresoj të shoh se jemi duke u përpjekur së bashku për një shoqëri ku shqiptarët dhe serbët dhe të gjitha komunitetet e tjera jetojnë së bashku në harmoni dhe me mirëkuptim e respektim të ndërsjellë.

Jam i bindur se mund ta krijojmë një shoqëri paqësore dhe përfshirëse ku në shtetin tonë multi-etnik diversiteti lartësohet, dhe ku çdo individ ndihet i vlerësuar dhe i respektuar.

Ju falemnderit për përkushtimin tuaj për këtë kauzë fisnike.

Sinqerisht,

Dr. Robert Muharremi

**Dušan Radaković, Drejtor Ekzekutiv
Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC)
Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

I nderuar Kryetar i Komunës, Përparim Rama,

Unë quhem Dušan Radaković, dhe jam Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC - Advocacy Center for Democratic Culture). I lindur në vitin 1984 në Mitrovicë, unë kam qenë thellësisht i përkushtuar për nxitjen e dialogut dhe bashkëpunimit ndëretnik që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë. Gjatë viteve kam marrë pjesë në nisma të shumta multietnike, duke punuar së bashku me organizata të ndryshme ndërkombëtare për ta promovuar paqen dhe mirëkuptimin ndërmjet komuniteteve të ndryshme.

Me Gradën Master në Drejtësi, dhe me një përvojë të madhe në shoqërinë civile, përfshirë rolet në media dhe në menaxhimin e projekteve, unë kam kushtuar përkrahjes së vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut. Qëllim i kësaj letre times është t'i ndaj pritjet dhe dëshirat e mia personale lidhur me përparimin e bashkëjetesës multietnike në Kosovë, si pjesë e Karvanit Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë.

Unë pres që lidhshipi juaj të hapë rrugën për politika gjithëpërfshirëse të zhvillimit urban që i akomodojnë dhe lartësojnë të gjitha komunitetet etnike në Prishtinë. Nxitja e ngjarjeve publike që promovojnë diversitet kulturor dhe mbështetja e forumeve të dialogut ndëretnik do të ishin vendimtare.

Dëshira ime është ta shoh një të ardhme ku bashkëjetesa multietnike në Kosovë është normë, dhe posaçërisht në komunat si Prishtina. Unë përfytyroj komunitete ku dallimet etnike lartësohen si anë të forta, jo si burime ndarjeje. Lidhur me këtë, synimet afatgjata përfshijnë krijimin e programeve të qëndrueshme që promovojnë edukimin për diversitetin kulturor, përkrahjen e ndërmarrjeve të përbashkëta ekonomike ndërmjet grupeve të ndryshme etnike, dhe sigurimin e përfaqësimit të barabartë në qeverisjen lokale.

Po e shfrytëzoj këtë mundësi për t'ju nxitur që të angazhoheni aktivisht në ndërtimin e një komuniteti paqësor dhe gjithëpërfshirës duke mbështetur iniciativat ndëretnike, duke promovuar politika që sigurojnë mundësi të barabarta për të gjithë dhe duke inkurajuar dialogun e hapur dhe me respektim ndërmjet grupeve të ndryshme etnike.

Këtë letër po e përfundoj me një shënim pozitiv, duke shprehur shpresën time për një të ardhme më të ndritur, ku përpjekjet tona kolektive do të çojnë në një shoqëri vërtet harmonike dhe multietnike në Kosovë. Unë kam besim se me angazhimin tonë të përbashkët ne mund të bëjmë hapa të rëndësishëm drejt kësaj kauze fisnike.

Përshëndetje të përzemërta,

Dušan Radaković

**Ilir Deda,
Aktivist i Shoqërisë Civile
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Kryetar Rama,

Për më shumë se dy dekada me radhë, unë, në role të ndryshme, kam qenë i përfshirë dhe i angazhuar në çështjet kyçe për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor, përfshirë këtu edhe ruajtjen dhe përparimin e diversitetit në vendin tonë. Qëllim i kësaj letre është t'i shikojë mundësitë për ta filluar krijimin e kulturës së paqes në vendin tonë dhe për ta zgjeruar përfshirjen tuaj në promovimin e Prishtinës si qytet i hapur për të gjithë njerëzit, e që përfshin edhe bashkëjetesën multietnike në kryeqytetin tonë. Kjo është posaçërisht e rëndësishme tash kur qëndrimet populiste dhe përjashtuese kanë filluar të fitojnë hapësirë.

Besoj se janë disa hapa afatshkurtër dhe disa afatgjatë që ju mund t'i ndërmerrni dhe t'i shndërroni në praktika.

Në afat të shkurtër, një vizitë në fshatin Bërnice, ku banojnë shumica e serbëve vendas, do të ishte hapi i parë. Qëllim i kësaj vizite duhet të jetë që nga popullata lokale të dëgjohet gjendja aktuale të punëve dhe të hetohen mundësitë e më tutjeshme që komuna t'i adresojë nevojat e tyre. Po të jetë e mundshme, mund të vendoset një dialog i përhershëm me komunitetin dhe të avancohen projektet e zhvillimit lokal, përfshirë këtu edhe futjen e masave të veçanta për ta ruajtur komunitetin dhe mirëqenien e tij.

Vizita e dytë prioritare do të ishte në Kishën e Shën Nikollës dhe takimi me Dhjakun e Kishës. Kisha luan një rol të rëndësishëm për popullatën serbe dhe vizita mund të rezultojë me një të kuptuar më të madh dhe më të mirë nga ana e Zyres suaj për nevojat e Kishës, dhe po ashtu edhe me një ndihmë të shtuar për serbët që jetojnë në komunën e Prishtinës. Kisha ka një pasqyrë shumë të saktë për numrin e serbëve që jetojnë në komunën tonë si dhe për nevojat e tyre të veçanta, e të cilat të dhëna Zyra juaj më pas mund t'i adresojë.

Ju keni një rol qendror për transformimin e kryeqytetit tonë duke hetuar mënyrat për të krijuar struktura të bazuara në vlera që Prishtinës do t'i mundësonin të jetë kryeqytet i hapur për të gjithë. Në këtë drejtim, ju sugjeroj të merrni parasysh nismat e mëposhtme afatgjata për të nxitur harmoni ndëretnike dhe ndërfitare në Prishtinë:

1. Formimi i një forumi të përhershëm me përfaqësuesit e popullsisë në Bërnice, i cili do të mbledhë jo më shumë se 4 herë në vit, e ku do të diskutoheshin dhe trajtoheshin çështje të hapura në fushën e qeverisjes;
2. Krijimi i një këshilli për dialog ndërfitar me përfaqësuesit e Bashkësisë Islame, Kishës Katolike, Kishës Protestante dhe Kishës Ortodokse Serbe. Ky këshill mund të shërbejë edhe si bazë për dialog të rregullt ndërmjet komunës dhe institucioneve fetare lokale, përfshirë këtu edhe mirëkuptimin më të madh ndërmjet liderëve fetarë lokalë;
3. Nisma Prishtina Qytet i Hapur për të Gjithë – ky aksion do ta përfshinte një vizion për një kryeqytet paqësor dhe përfshirës.

Unë besoj fuqishëm se lidershipi juaj është vendimtar në këtë pikë të zhvillimit të vendit tonë dhe shpreh shpresën se do t'i merrni parasysh veprimet e propozuara.

Përsëritet të sinqerta,

Ilir Deda

**Senad Šabović, Këshilltar i Lartë
Instituti Evropian për Paqe
Bruksel - Prishtinë**

I nderuari Kryetar i Komunës Rama,

Unë quhem Senad Šabović, dhe po Ju shkruaj si përkrahës i projektit të quajtur Karvani Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë. Unë punoj si Këshilltar i Lartë në Institutin Evropian për Paqe, me përqendrimin kryesor në mbështetjen e Dialogut të ndihmuar nga BE-ja dhe të procesit të normalizimit në përgjithësi. Organizata ime është pjesë e një koalicioni të shoqërisë civile të quajtur Alternativa Qytetare e Kosovës (AKK), e cila përpiqet ta japë një kontribut të prekshëm në këtë fushë. Pos disa qëndrimeve të shkurtra jashtë vendit, unë kam qenë një qytetar krenar i Prishtinës, dhe dua ta shfrytëzoj këtë rast që t'ju falënderohem për udhëheqjen dhe menaxhimin tuaj vizionar të qytetit tonë të dashur.

Me këtë letër dua t'i shpreh pritjet e mia nga Ju sa i përket multietnicitetit dhe bashkëjetesës. Siç dimë, Republika e Kosovës përkufizohet si shtet multietnik i të gjithë qytetarëve dhe komuniteteve të saj. Këto parime janë të rrënjësura thellë në sistemin kushtetues dhe ligjor të Kosovës. Ato po ashtu vazhdojnë të jenë edhe pritja kryesore e partnerëve tanë perëndimorë dhe e sistemit organizativ të komunitetit euroatlantik, hyrjen në të cilin ne e aspirojmë. Si të tilla, parimet e multietnicitetit, mirëkuptimit dhe të bashkëjetesës paqësore duhet të pasqyrohen plotësisht në Kryeqytetin tonë. Në këtë drejtim është bërë punë e madhe nga qyteti dhe shteti, mirëpo ajo duhet të forcohet dhe zgjerohet edhe më tutje, posaçërisht në këtë kohë të tendosjeve të shtuara dhe të ngecjes në normalizim. Unë i kam vënë re dhe i vlerësoj lartë disa nga kontributet Tuaja në këtë drejtim. Në veçanti janë për t'u lavdëruar mbështetja juaj për qendrën e komunitetit boshnjak në Prishtinë, si dhe angazhimi juaj me Kryetarin e Komunës së Sarajevës. Qasja juaj jopopuliste dhe e orientuar drejt menaxhimit është po ashtu shumë e vlerësuar si e favorshme për angazhimet praktike ndër-komunitare.

Unë dhe kolegët nga projekti do të donim, edhe t'ju inkurajojmë për t'i zgjeruar këto nisma, dhe edhe t'ju ofrojmë disa sugjerime të reja në këtë drejtim. Thënë përgjithësisht, përdorimi i mundësive të ofruara për ta theksuar multietnicitetin si vlerë është jashtëzakonisht i dobishëm. Kjo mund të përfshijë njoftime të përbashkëta për shtyp, ose përmbajtje të mediave sociale nga Ju dhe komuna në gjuhët e komuniteteve, për shembull me rastin e ditëve të tyre kombëtare ose të festave fetare. Kjo mund të përfshijë po ashtu edhe vizitat tuaja të publikuara në qendrat e komuniteteve në komunë, të tilla si qendra e komunitetit serb pranë Kishës Ortodokse të Prishtinës, qendra boshnjake në Prishtinë, ose ndonjë vend i ngjashëm për komunitetin rom. Duke inkurajuar bashkëjetesën paqësore dhe multietnicitetin, deklaratat e përbashkëta lidhur me këto vizita do të ishin tejet të mirëseardhura.

Më konkretisht, Ju mund ta ndërmerrni nismën për projekte të përbashkëta ndërkomunale të udhëhequra nga Prishtina dhe të realizuara nga komuna të përzgjedhura multietnike, të tilla si Graçanica, Kamenica apo Shtërpca. Kjo do të ishte një mënyrë e shkëlqyer për t'u angazhuar në ndërtimin e besimit të orientuar drejt zhvillimit. Kjo mund të zhvillohet në një strukturë të qëndrueshme të bashkëpunimit ndërkomunal, i cili më pas do të mund të angazhohej me Asociacionin e Komunave të Kosovës në projekte që e pasqyrojnë të njëjtin koncept.

I nderuari Kryetar i Komunës, ju mund të jeni të sigurtë se kolegët e mi nga Instituti Evropian i Paqes, ata nga ky projekt, si dhe ata nga koalicioni i përmendur i AQK-së, do të ishin më se të gatshëm për të ofruar mbështetje konkrete për ju dhe ekipin tuaj në zbatimin e sugjerimeve që janë duke u ofruar këtu.

Me respekt dhe vlerësim të lartë,
Senad Šabović

**Ramadan Ilazi, Udhëheqës i Hulumtimeve
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Kryetar Rama,

Quhem Ramadan Ilazi, dhe aktualisht jam udhëheqës i hulumtimeve në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Me një prapavijë në studimet për paqe dhe konflikte, me diplomë master nga Universiteti St. Andrews, dhe doktoraturë nga Universiteti i Qytetit të Dublinit (DCU), unë karrierën time ia kam kushtuar promovimit të Kosovës si një shoqëri demokratike dhe e shumëllojshme. Rolet e mia kanë përfshirë të qenit aktivist, udhëheqjen e organizatave, dhe shërbimin si Zëvendësministër për Integritet Evropian.

Kushtetuta e Kosovës fillon me vizionin e ndërtimit të një të ardhmeje si një vend i lirë, demokratik dhe paqedashës për të gjithë qytetarët e saj. Ky vizion është thelbësor, dhe realizimi i tij është përgjegjësi jona kolektive. Në qendër të këtij vizioni është ideja që Kosova është shtëpia e të gjithë qytetarëve të saj, të cilët duhet ta kenë ndjenjën e përkatësisë dhe të krenarisë.

Diversiteti është forca thelbësore e Kosovës dhe ai duhet të lartësohet dhe të ushqehet. Shoqëria civile dhe institucionet publike duhet të punojnë së bashku për ta nxitur tolerancën, bashkëjetesën dhe edukimin kundër diskriminimit.

Si Kryetar i Komunës së Prishtinës, roli juaj në promovimin e diversitetit është jetik. Udhëheqja juaj mund të frymëzojë diskurs politik dhe politika përfshirëse. Ju inkurajoj t'i zbatoni nismat që e lartësojnë diversitetin kulturor dhe etnik të Kosovës në shkollat tona. Për shembull, organizimi i ngjarjeve në shkollat fillore dhe të mesme të Prishtinës që nxjerrin në pah kulturat, ushqimet dhe traditat e ndryshme, mund të nxisin një ndjenjë uniteti. Mësuesit mund të fuqizohen për t'i hetuar temat e barazisë, tolerancës dhe të pranimit përmes artit dhe aktiviteteve në klasë. Krijimi i klubeve aktive të debatit nëpër shkolla mund ta mësojë të menduarit kritik dhe t'i ndihmojë studentët t'i kuptojnë perspektivat e ndryshme.

Për më tepër, organizimi i vizitave kulturore për nxënësit për ta përjetuar nga afër pasurinë e diversitetit të Kosovës mund të jetë transformues. Këto nisma mund ta krijojnë një model bashkëjetese që i frymëzon rajonet e tjera dhe ndërton një shoqëri më kohezive.

Mbes me shpresë dhe besim në angazhimin tuaj për këtë kauzë.

Ju falemnderit,

Ramadan Ilazi

Dimitrije Obrenović,
Koordinator i Projekteve,
NGO Aktiv
Mitrovica e Veriut, Kosovë

I dashuri z. Rama,

Shpresoj që kjo letër do t'ju gjejë mirë. Unë quhem Dimitrije Obrenović, një aktivist serb i Kosovës i shoqërisë civile nga Mitrovica e Veriut. Jam thellësisht i përkushtuar ndaj përpjekjeve për pajtim midis serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës. Jam duke shkruar si pjesë e Karvanit Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë për t'i ndarë pritjet dhe dëshirat e mia për bashkëjetesë multietnike në Kosovë.

Si Kryetar i Komunës, roli juaj për promovimin e politikave dhe ngjarjeve përfshirëse që i lartësojnë kulturat tona të ndryshme është thelbësor. Ju bëj thirrje të angazhoheni me komunitetet joshumicë, t'i adresoni brengat e tyre, ta siguronit përfaqësimin e tyre në qeverisjen lokale dhe ta mundësoni kthimin e serbëve të Kosovës.

Duke shikuar përpara, vizioni im është ai i një Kosove ku bashkëjetesa multietnike është realitet. Shpresoj se në Prishtinë do të shoh qendra dhe nisma ndërkulturore që promovojnë dialogun, si dhe projekte të përbashkëta të komunitetit. Krijimi i një "Këshilli të Bashkëjetesës" me përfaqësues të grupeve të ndryshme etnike mund të jetë një hap i rëndësishëm drejt këtij qëllimi.

Në përfundim, ju inkurajoj të vazhdoni ta ndërtoni një komunitet paqësor dhe përfshirës. Udhëheqja juaj mund t'i frymëzojë të tjerët për ta ndjekur shembullin, duke krijuar një të ardhme në të cilën në Kosovë të gjithë do të ndjehen si në shtëpinë e vet.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Sinqerisht,

Dimitrije Obrenović

Mentor Agani, Hulumtues i Lartë
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave
Prishtinë, Kosovë

I nderuari Kryetar Rama,

Unë jam Mentor Agani, dhe jam Hulumtues i Lartë në KIPRED, Instituti Kosovar për Hulimtim dhe Zhvillim të Politikave, si dhe ligjërues në Kolegjin Dardania në Prishtinë. Gjatë periudhës 2003-2016 kam qenë po ashtu edhe ligjërues në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Këtë letër po e shkruaj me synimin për t'i shprehur disa nga pritjet dhe dëshirat e mia lidhur me bashkëjetesën ndëretnike në Kosovë.

Jam i bindur se ju dhe Komuna e Prishtinës nën udhëheqjen tuaj mund ta jepni një kontribut të çmuar për këtë. Komuna e Prishtinës nuk është vetëm kryeqytet i Kosovës dhe i të gjithë qytetarëve të saj, por është edhe kryeqytet i të gjitha bashkësive etnike të Kosovës – diçka që shpeshherë shpërfilllet për faktin se kjo komunë nuk karakterizohet me ndonjë nivel të lartë të përzierjes etnike të popullsisë së vet. Por ky aspekt nuk bën të neglizhohet: Prishtina duhet domosdoshmërisht ta pasqyrojë veten si kryeqytet i të gjitha komuniteteve etnike të Kosovës, dhe posaçërisht i komunitetit serb – nëse Prishtina veten nuk e konsideron si kryeqytet të serbëve të Kosovës, atëherë problemi nuk është ai se serbët e Kosovës Prishtinën nuk do ta konsiderojnë si kryeqytet të vetin, dhe se, rrjedhimisht, kryeqytetin e tyre do ta kërkojnë diku tjetër, por ai se ata në këtë rast do të kenë të drejtë legjitime për ta bërë këtë.

Komuna e Prishtinës, me të gjitha drejtoritë e veta, duhet të vendosë kontakte me serbët e Kosovës (nga Prishtina, nga komunat përreth saj, si dhe nga e gjithë Kosova), në mënyrë që të konstatohet se çfarë ajo mund të bëjë që serbët e Kosovës Prishtinën ta ndjejnë si kryeqytet të vetin. Si ide, Komuna e Prishtinës mund ta vendosë një Ditë Vjetore të Multietnicitetit, në ndonjë datë të caktuar gjatë vitit, në të cilën do të organizohet një takim i qytetarëve të të gjitha komuniteteve etnike, dhe posaçërisht i shqiptarëve dhe serbëve, në ndonjë shesh të Prishtinës, dhe që do të pasohet me një Marsh Multietnik nëpër qytet, dhe me vizitën e tyre të përbashkët në kafenetë dhe restorantet e Prishtinës.

Përmes bashkëpunimit ndër-komunal, kjo Ditë e Multietnicitetit (e Prishtinës) do të mund të organizohet edhe në komunat përreth me shumicë serbe (ose me pjesë të konsiderueshme të popullsisë serbe), e të cilat po ashtu do të organizonin Marshime të Multietnicitetit, por tash me serbët që i presin shqiptarët. Kjo mund të krijojë mundësi që shqiptarët e serbët të konkurrojnë në mikpritje.

Kuptohet, kjo mund të shoqërohet me aktivitete të tjera të shumta të përbashkëta profesionale shqiptare/serbe, si, për shembull, takime dhe konferenca për çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet komunale, dhe posaçërisht me ato që kanë të bëjnë me bashkëjetesën ndëretnike.

Kjo është vetëm një ide, dhe mund të gjejmë edhe shumë të tjera të ngjashme. Çdo drejtori komunale mund të japë ide për bashkëpunimin ndëretnik. Dhe qëllimi gjithmonë duhet të jetë ai që serbët e Kosovës ta kuptojnë se Prishtina ata i konsideron qytetarë të vet. Dhe nëse kjo serbët e Kosovës i bën që Prishtinën ta konsiderojnë si kryeqytetin e tyre, Kosova gjithsesi do të shndërrohet në një vend më të mirë për të jetuar në të.

Ju falemnderit dhe përsëndetjet më të përzemërta,

Mentor Agani

Zoran Savič, Koordinator i Projekteve
NGO AKTIV
Mitrovicë e Veriut, Kosovë

I dashuri Kryetar i Komunës Përparim Rama,

Quhem Zoran Savič dhe jam Koordinator i Projekteve në organizatën joqeveritare Aktiv të Mitrovicës së Veriut. Edhe pse jam lindur në Pulë të Kroacisë, unë në të vërtetë kam jetuar në Mitrovicë për 30 vite dhe jam i përfshirë aktivisht në jetën shoqërore të Kosovës, si përmes punës, ashtu edhe përmes jetës kulturore, duke pasur parasysh se jam edhe muzikant dhe kam marrë pjesë në projekte të shumta ndëretnike me muzikantë të kombësisë shqiptare.

Në të njëjtën kohë, për shumë vite kam punuar si gazetar në portalin Kosova Sever – KoSSev, dhe përmes kësaj pune u njoha edhe më shumë me situatën politike dhe të sigurisë në Kosovë. Unë edhe sot bashkëpunoj me shumë gazetarë dhe redaktorë shqiptarë, si në aspektin e projekteve, ashtu edhe përmes punëve që nuk janë të ndërlidhura me to.

Pozita juaj si Kryetar i Prishtinës, i kryeqytetit të Kosovës, mund të ndihmojë në një masë të madhe në promovimin e mesazheve të paqes dhe të unitetit. Prandaj, në të ardhmen e pres mbështetjen tuaj në organizimin e dialogjeve ndëretnike dhe të projekteve në shërbim të komunitetit që përfshijnë grupe të ndryshme etnike duke punuar së bashku.

Në këtë frymë, shpresoj për një të ardhme ku bashkëjetesa multietnike në Kosovë do të bëhet normë. Unë parashoh komunitete ku dallimet etnike merren si anë të forta, jo si burime ndarjeje. Për këtë qëllim, ju mund të përqendroheni në krijimin e programeve të qëndrueshme që edukojnë për diversitet kulturor dhe tolerancë, që mbështesin projekte të përbashkëta të komunitetit, dhe sigurojnë përfaqësim të barabartë të të gjitha grupeve etnike në qeverisjen lokale.

Prandaj, ju inkurajoj të merrni pjesë aktive në krijimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës duke mbështetur nisma ndëretnike, duke përkrahur politika që garantojnë mundësi të barabarta për të gjithë, dhe duke nxitur dialog të hapur dhe me respektim midis grupeve të ndryshme etnike.

E përfundoj këtë letër me një vërejtje shpresëdhënëse, duke parashikuar një të ardhme ku përpjekjet tona të bashkuara do ta kultivojnë një shoqëri vërtet harmonike dhe multietnike në Kosovë. Jam i sigurtë se me përkushtimin tonë të përbashkët, ne mund ta arrijmë një përparim të jashtëzakonshëm drejt këtij qëllimi të çmuar.

Zoran Savič



Letrat e Dëshirave dhe Pritjeve

Leonora Kryeziu, Jovana Radosavljević, Robert Muharremi, Dušan Radaković, Ilir Deda, Senad Sabović, Ramadan Ilazi, Dimitrije Obrenović, Mentor Agani dhe Zoran Savić

z. Naim ef. Tërnavë

Myfti i Kosovës

Korrik 2024

**Leonora Kryeziu, Drejtoreshë Ekzekutive
Instituti i Prishtinës për Studime Politike
Prishtinë, Kosovë**

I nderuar Mufti Tërnavë,

Unë jam Leonora Kryeziu, banore e Prishtinës, e lindur në vitin 1971. Duke qenë se i takoj një gjenerate që fëmijërinë dhe rininë e kam kaluar në ish-Jugosllavi, mbaj mend mirë se si dukej bashkëjetesa multi-etnike në Prishtinë, me ngjyrimet e veta sa të errëta, po aq edhe të bukura, të një bashkëjetese deri diku të qetë.

Me këtë letër, dua t'i ndaj me ju pritjet dhe dëshirat e mia personale lidhur me promovimin e kohezionit social ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij serb në kryeqytet, dhe jo vetëm duke përmendur shembuj të së kaluarës por edhe mundësitë që na i ofron e tashmja.

Lidhur me komunitetin fetar, vlerësoj thellësisht rolin që udhëheqësit fetarë e luajnë në promovimin e unitetit dhe të kuptimit reciprok në mes të grupeve etnike dhe fetare të ndryshme. Në një shoqëri shpesh të ndarë përmes vijave etnike, besoj se feja ka fuqi për t'i bashkuar njerëzit dhe për t'i frymëzuar ata drejt paqes dhe harmonisë.

Ju e keni një rol shumë të rëndësishëm në transmetimin e mesazheve të tolerancës dhe paqes, duke inkurajuar besimtarët tuaj që këto vlera t'i pranojnë si të rëndësishme për bashkëjetesën tonë. Nismat e përbashkëta humanitare dhe programet e shërbimit në komunitet mund të ndihmojnë në tejkalimin e ndarjeve dhe në kultivimin e solidaritetit midis komuniteteve shqiptare dhe serbe. Duke u angazhuar në aktivitete të tilla të përbashkëta, ne mund të ndërtojmë marrëdhënie të bazuara në dashamirësi dhe në vlerësim reciprok.

Le të përpiqemi së bashku për ta krijuar një shoqëri ku çdo banor, pa marrë parasysh etninë apo origjinën, do të ndihet i vlerësuar dhe i respektuar. Unë besoj në aftësinë tonë të përbashkët për ta ndërtuar një komunitet harmonik për brezat e ardhshëm.

Me respekt,

Leonora Kryeziu

Jovana Radosavljevič, Drejtoreshë Ekzekutive
New Social Initiative
Mitrovicë e Veriut, Kosovë

I dashuri Myfti Tërnavë,

Shpresoj që kjo letër do t'ju gjejë mirë. Unë quhem Jovana Radosavljeviq, dhe jam një aktiviste serbe e Kosovës e shoqërisë civile nga Mitrovica e Veriut, që punon në përpjekjet për pajtimin midis serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës. Jam duke ju shkruar si pjesë e Karvanit Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë për të ndarë pritjet dhe dëshirat e mia për bashkëjetesën multietnike në Kosovë.

Udhëheqja juaj në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës mund ta promovojë në një masë të madhe bashkëjetesën ndëretnike. Inkurajimi i dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet grupeve të ndryshme fetare dhe etnike mund të ndërtojë ura mirëkuptimi. Ju nxis që t'i mbështesni programet e komunitetit që bashkojnë njerëz me prejardhje të ndryshme dhe që promovojnë projekte të përbashkëta të shërbimit në komunitet.

Duke shikuar përpara, unë parashoh një Kosovë ku bashkëjetesa multietnike përvetësohet. Takimet e rregullta ndërfitare dhe nismat ndërkulturore mund ta nxisin dialogun dhe bashkëpunimin. Predikimet dhe fjalimet tuaja publike mund ta theksojnë unitetin, tolerancën dhe respektimin e të gjithëve.

Në përfundim, ju inkurajoj t'i vazhdoni përpjekjet tuaja për ndërtimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës. Udhëheqja juaj mund t'i frymëzojë të tjerët për të krijuar një të ardhme ku në Kosovë të gjithë të ndihen si në shtëpinë e vet.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Sinqerisht,

Jovana Radosavljević

Dr. Robert Muharremi
Fred C. Cuny Center for Peace and Conflict Studies
Rochester Institute of Technology in Kosovo
Prishtinë, Kosovë

I dashuri Myfti i Kosovës, z. Naim ef. Tërnavë

Jam duke shkruar për ta shprehur respektin tim më të thellë për udhëheqjen tuaj dhe rolin e rëndësishëm që e luani në rritjen e paqes dhe të mirëkuptimit përbrenda Kosovës. Qendra Fred C. Cuny për Studime të Paqes dhe të Konfliktëve në Institutin Rochester të Teknologjisë në Kosovë ofron një platformë akademike për studimin dhe mësimin e shkaqeve, të praktikave dhe të pasojave të luftës dhe dhunës politike, si dhe të metodave të menaxhimit dhe zgjidhjes së konflikteve. Hulumtimi jonë ndihmon akademikët, qeveritë, praktikuesit dhe shoqërinë civile për ta kuptuar natyrën e konfliktit dhe për t'i formuluar politikat efektive të zgjidhjes. Qendra jonë është në krye të bashkimit të qendrave kërkimore dhe të organizatave të shoqërisë civile që përfaqësojnë komunitetet e ndryshme të Kosovës dhe nxisin një klimë të mirëkuptimit dhe të tolerancës së ndërsjellë.

Jam duke ju shkruar për ta shprehur mbështetjen e plotë, si timen, ashtu edhe të Qendrës sonë, për nismën e Karvanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë. Kosova është një shoqëri multietnike, demokratike dhe pluraliste, dhe besoj se respektimi i Kushtetutës së Kosovës, e cila i ruan këto vlera dhe orientimin euroatlantik të Kosovës, nuk është vetëm kritik, por është edhe vetë thelbi i asaj që Kosova përfaqëson.

Si një udhëheqës i respektuar nga të gjitha komunitetet, zëri juaj e ka një peshë domethënëse. Shpresoj se do të angazhoheni aktivisht në promovimin e tolerancës etnike, kulturore dhe fetare ndërmjet të gjitha komuniteteve në Kosovë. Ju bëj thirrje ta vazhdoni punën tuaj të paçmuar në promovimin e një Kosove multietnike ku të gjithë qytetarët, pavarësisht prejardhjes së tyre, do të ndjehen të respektuar dhe të sigurtë. Udhëzimet tuaja mund të frymëzojnë tolerancë dhe mirëkuptim fetar, duke inkurajuar dialogun dhe bashkëpunimin e vërtetë midis të gjitha komuniteteve. Kjo do të jetë thelbësore për një Kosovë paqësore që i përket të gjitha komuniteteve të saj.

Shpresoj se do të shoh se jemi duke u përpjekur së bashku për një shoqëri ku shqiptarët dhe serbët dhe të gjitha komunitetet e tjera do të jetojnë së bashku në mënyrë harmonike, me mirëkuptim, dhe respektim të ndërsjellë.

Jam i bindur se mund ta krijojmë një shoqëri paqësore dhe përfshirëse ku diversiteti në shtetin tonë multietnik do të lartësohet dhe ku çdo individ do të ndjehet i vlerësuar dhe i respektuar.

Ju falemnderit për përkushtimin tuaj për këtë kauzë fisnike.

Sinqerisht,

Dr. Robert Muharremi

Dušan Radaković, Drejtor Ekzekutiv
Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC)
Mitrovicë e Veriut, Kosovë

I dashuri Myfti, Naim ef. Tërnavë,

Unë quhem Dušan Radaković, dhe jam Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC - Advocacy Center for Democratic Culture). I lindur në vitin 1984 në Mitrovicë, unë kam qenë thellësisht i përkushtuar për nxitjen e dialogut dhe bashkëpunimit ndëretnik që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë. Gjatë viteve kam marrë pjesë në nisma të shumta multietnike, duke punuar së bashku me organizata të ndryshme ndërkombëtare për të promovuar paqen dhe mirëkuptimin ndërmjet komuniteteve të ndryshme.

Me Gradën Master në Drejtësi, dhe me një përvojë të madhe në shoqërinë civile, përfshirë rolet në media dhe në menaxhimin e projekteve, unë kam kushtuar përkrahjes së vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut. Qëllim i kësaj letre times është t'i ndaj pritjet dhe dëshirat e mia personale lidhur me përparimin e bashkëjetesës multietnike në Kosovë, si pjesë e Karvanit Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë.

Pozita juaj me ndikim në komunitetin mysliman mund ta ndihmojë përhapjen e mesazheve të paqes dhe të unitetit. E pres mbështetjen tuaj në organizimin e dialogjeve ndërfetare dhe të projekteve të shërbimit në komunitet të cilat do të përfshijnë grupe të ndryshme fetare duke punuar së bashku.

Në këtë frymë, unë shpresoj për një të ardhme ku bashkëjetesa multietnike do të bëhet normë në Kosovë. Unë parashoh komunitete në të cilat dallimet etnike dhe fetare do të trajtohen si anë të forta, dhe jo si burime të ndarjes. Për këtë qëllim, ju mund të përqendrohemi në krijimin e programeve të qëndrueshme që edukojnë për diversitet kulturor dhe tolerancë, që mbështesin projekte të përbashkëta të komunitetit, dhe që sigurojnë përfaqësim të barabartë të të gjitha grupeve etnike dhe fetare në qeverisjen lokale.

Prandaj ju inkurajoj të merrni pjesë aktive në krijimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës, duke mbështetur nisma ndëretnike, duke avokuar për politika që garantojnë mundësi të barabarta për të gjithë, dhe duke nxitur dialog të hapur dhe me respektim ndërmjet grupeve të ndryshme etnike dhe fetare.

Këtë letër e përfundoj me një shënim shpresëdhënës, duke parashikuar një të ardhme ku përpjekjet tona të bashkuara do ta çojnë përpara një shoqëri vërtet harmonike dhe multietnike në Kosovë. Jam i sigurtë se me përkushtimin tonë të përbashkët ne mund të arrijmë përparim të jashtëzakonshëm drejt këtij qëllimi të çmuar.

Dušan Radaković

**Ilir Deda,
Aktivist i Shoqërisë Civile
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Myfti Ternava,

Për më shumë se dy dekada me radhë, unë kam qenë i përfshirë dhe i angazhuar në role të ndryshme në çështjet kyçe për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor, përfshirë këtu edhe ruajtjen dhe përparimin e diversitetit në vendin tonë.

Qëllim i kësaj letre është t'i shikojë mundësitë për ta zgjeruar përfshirjen tuaj në promovimin e Prishtinës si një qytet të hapur për të gjithë njerëzit, që përfshin bashkëjetesën multietnike dhe multifetare në kryeqytetin tonë. Kjo është posaçërisht e rëndësishme në këtë kohë kur qëndrimet populliste dhe përjashtuese janë duke fituar hapësirë.

Harmonia ndërjetare ka qenë një ndër vlerat thelbësore të kombit tonë, dhe Bashkësia Islame e Kosovës ka rol qendror për ruajtjen dhe promovimin e kësaj vlere. Unë besoj se janë disa veprime afatshkurtra dhe disa afatgjata që ju mund t'i ndërmerri dhe që ato t'i shndërroni në praktika. Disa prej tyre burojnë nga praktikatat e mëparshme.

Në të kaluarën ka ekzistuar një praktikë ku udhëheqësit fetarë njëri-tjetrit ia uronin publikisht festat më të rëndësishme fetare. Rivendosja e kësaj praktike, edhe pse simbolike, do të ishte një hap fillestar drejt avancimit të respektimit ndërjetar në vendin tonë. Kjo do të thotë respekt për festat më të rëndësishme fetare për anëtarët e komuniteteve katolike, protestante dhe ortodokse.

Dialogu ndërjetar dhe mirëkuptimi më i madh është një formë moderne që synon avancimin e bashkëjetesës dhe të harmonisë ndërjetare. Edhe pse jetojmë në një kohë kur harmonia nuk është duke u vlerësuar, unë besoj se Kosova, duke pasur parasysh historinë e saj unike, mund ta vendosë një dialog ndërjetar në nivelin lokal komunal, për ta filluar krijimin e kulturës së paqes. Ky forum do ta çonte përpara mirëkuptimin e ndërsjellë midis udhëheqësve fetarë lokalë, duke përfshirë këtu edhe mirëkuptimin me autoritetet komunale lokale. Ai do të shërbente po ashtu edhe si një forum për t'i diskutuar dhe adresuar nevojat përkatëse të çdonjërit nga komunitetet fetare.

Së fundi, vizita te krerët fetarë lokalë ortodoksë do ta kishte një ndikim të rëndësishëm në përparimin e bashkëjetesës paqësore ndëretnike në vendin tonë. Kosova do të ketë sukses vetëm nëse e ruan karakterin e saj multietnik dhe Bashkësia Islame e Kosovës e ka një rol vendimtar në ruajtjen dhe avancimin e këtij karakteri të shtetit tonë.

Unë besoj fuqishëm se udhëheqësia juaj është kritike në këtë pikë të zhvillimit të vendit tonë dhe shpreh shpresën se do t'i merrni parasysh veprimet e propozuara.

Me përshëndetjet më të sinqerta,

Ilir Deda

**Senad Šabović, Këshilltar i Lartë
Instituti Evropian për Paqe
Bruksel – Prishtinë**

I nderuari Myfti Tërnavë,

Unë quhem Senad Šabović, dhe po Ju shkruaj si përkrahës i projektit të quajtur Karvani Shumëetnik për Paqe dhe Bashkëjetesë. Unë punoj si Këshilltar i Lartë në Institutin Evropian për Paqe, me përqendrimin kryesor në mbështetjen e Dialogut të ndihmuar nga BE-ja dhe të procesit të normalizimit në përgjithësi. Organizata ime është pjesë e një koalicioni të shoqërisë civile të quajtur Alternativa Qytetare e Kosovës (AKK), e cila përpiqet ta japë një kontribut konkret në këtë fushë.

Kjo letër synon t'i shprehë pritjet e mia nga Ju sa i përket multietnicitetit dhe bashkëjetesës. Siç dimë, Republika e Kosovës përkufizohet si shtet multietnik i të gjithë qytetarëve dhe komuniteteve të saj. Këto parime janë të rrënjësura thellë në sistemin kushtetues dhe ligjor të Kosovës. Ato po ashtu vazhdojnë të jenë edhe pritja kryesore e partnerëve tanë perëndimorë dhe e sistemit organizativ të komunitetit euroatlantik, hyrjen në të cilin ne e aspirojmë. Si të tilla, parimet e multietnicitetit, mirëkuptimit dhe të bashkëjetesës paqësore duhet të pasqyrohen plotësisht në jetën fetare të vendit tonë. Në këtë drejtim është bërë punë e madhe, por ajo duhet të forcohet dhe të zgjerohet edhe më tutje, dhe posaçërisht në këtë kohë të shtimit të tendosjeve dhe të ngecjes së normalizimit. Me kalimin e viteve, dhe posaçërisht si Drejtor Politik i Misionit të OSBE-së në Kosovë (2015-2020), me një vlerësim të lartë i kam vërejtur disa nga kontributet Tuaja në këtë drejtim. Posaçërisht mbresëlënëse kanë qenë angazhimet tuaja me udhëheqësit dhe përfaqësuesit e feve të tjera të përfaqësuar në Kosovë, si dhe udhëheqja juaj në kontekstin e kornizave të ndryshme të dialogut ndërfaqësor dhe të nismave të ndryshme praktike të bashkëpunimit ndërfaqësor.

Unë dhe kolegët nga projekti do të donim, edhe t'ju inkurajojmë për t'i zgjeruar këto nisma, edhe t'ju ofrojmë disa sugjerime të reja në këtë drejtim. Thënë përgjithësisht, përdorimi i mundësive të ofruara për ta theksuar multietnicitetin si vlerë është jashtëzakonisht i dobishëm. Kjo mund të përfshijë njoftime të përbashkëta për shtyp, ose përmbajtje të mediave sociale, apo vizita të përbashkëta me udhëheqës të ndryshëm fetarë apo institucionalë në qendrat dhe vendet e rëndësishme komunitare. Ndihma e përfshirjes së respektimit për diversitetin fetar dhe etnik në Predikimet e Xhumasë – e që jam i sigurtë se tashmë është duke ndodhur – do të ishte po ashtu një mënyrë efektive e kontribuimit.

Në një mënyrë më konkrete, ju do të mund ta ndërmirni, së bashku me udhëheqësit e feve të tjera në Kosovë, një nismë drejt krijimit të një këshilli Ndër-Fetar i cili do ta koordinonte dhe këshillonte shtetin dhe donatorët ndërkombëtarë sa i përket mbrojtjes dhe riparimit të vendeve të cenueshme fetare anëmbanë Kosovës. Kjo jo vetëm që do ta shtonte mirëqenien fizike të këtyre vendeve, por po ashtu do ta rikonfirmonte vazhdimisht mesazhin e Paqes, që është i rrënjësor aq fuqishëm në Besimin Mysliman, si në Kosovë, ashtu edhe anëmbanë botës.

I nderuari Myfti, jini të sigurtë se kolegët e mi nga Instituti Evropian i Paqes, nga ky projekt, si dhe nga koalicioni i përmendur i KCA-së, do të jenë edhe më shumë se të gatshëm që të ofrojnë përkrahje konkrete për Ju dhe udhëheqësit fetarë të tjerë në zbatimin e sugjerimeve të dhëna këtu.

Me respekt dhe vlerësim të lartë,

Senad Šabović

**Ramadan Ilazi, Udhëheqës i Hulumtimeve
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Myfti ef. Tërnavë,

Quhem Ramadan Ilazi, dhe aktualisht jam udhëheqës i hulumtimeve në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Me një prapavijë në studimet për paqe dhe konflikte, me Diplomë Master nga Universiteti St. Andrews, dhe Doktoraturë nga Universiteti i Qytetit të Dublinit (DCU), unë karrierën time ia kam kushtuar promovimit të Kosovës si një shoqëri demokratike dhe e shumëllojshme. Rolet e mia kanë përfshirë të qenit aktivist, udhëheqjen e organizatave, dhe shërbimin si Zëvendësministër për Integritet Evropian.

Kushtetuta e Kosovës fillon me vizionin e ndërtimit të një të ardhmeje si një vend i lirë, demokratik dhe paqedashës për të gjithë qytetarët e saj. Ky vizion është thelbësor, dhe realizimi i tij është përgjegjësi jona kolektive. Në qendër të këtij vizioni është ideja që Kosova është shtëpia e të gjithë qytetarëve të saj, të cilët duhet ta kenë ndjenjën e përkatësisë dhe të krenarisë.

Diversiteti është forca thelbësore e Kosovës dhe ai duhet të lartësohet dhe të ushqehet. Shoqëria civile dhe institucionet publike duhet të punojnë së bashku për ta nxitur tolerancën, bashkëjetesën dhe edukimin kundër diskriminimit.

Si Kryemyfti i Kosovës, roli juaj në promovimin e paqes dhe tolerancës është i rëndësishëm më të lartë. Si fe paqedashëse, Islami duhet të jetë në krye të këtyre përpjekjeve. Ju inkurajoj që brenda xhamive të zbatoni mësimet që e theksojnë tolerancën, pranimin dhe vlerën e shoqërisë sonë të larmishme. Këto mësimet mund ta luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e një komuniteti më përfshirës dhe më mirëkuptues. Për shembull, gjatë ligjëratave të rregullta të xhumasë, hutbes, duhet të ketë të ftuar Hatib për ta mbajtur një ligjëratë mbi temën e tolerancës.

Për më tepër, propozoj organizim të takimeve të rregullta të përbashkëta midis të gjithë udhëheqësve fetarë në Kosovë. Këto takime mund të shërbejnë si platformë për dialog dhe bashkëpunim, duke çuar në deklaratat dhe nisma të përbashkëta që nxisin respektin e ndërsjellë midis komuniteteve të ndryshme fetare. Një bashkëpunim i tillë mund të jetë shembull i fuqishëm për të gjithë qytetarët dhe ky mund ta forcojë mesazhin e bashkëjetesës dhe të harmonisë. Nismat konkrete, të tilla si dialogjet ndër-fetare, projektet e shërbimit të komunitetit, dhe ngjarjet e shkëmbimit kulturor, përpjekjet tona mund t'i forcojnë edhe më tutje.

Mbes me shpresë dhe bindje për përkushtimin tuaj për këtë kauzë. Udhëheqja juaj dhe parimet e Islamit mund ta frymëzojnë një të ardhme ku diversiteti i Kosovës do të shihet si burim i fuqisë dhe krenarisë.

Ju falemnderit,

Ramadan Ilazi

Dimitrije Obrenović,
Koordinator i Projekteve,
NGO Aktiv
Mitrovica e Veriut, Kosovë

I dashuri Myfti, Naim ef. Tërnavë,

Qhem Dimitrije Obrenović, dhe jam një aktivist për të drejtat e njeriut që jeton në Mitrovicën e Veriut. Unë përpiqem për të drejta të barabarta të njeriut dhe për nxitje të bashkëpunimit ndërfaqësor më të mirë, duke besuar fuqishëm se për një të ardhme më të mirë kërkohet bashkëpunim i mëtutjeshëm.

Pozita juaj me ndikim në komunitetin mysliman mund të ndihmojë në promovimin e mesazheve të paqes dhe të unitetit. Në të ardhmen e pres mbështetjen tuaj në organizimin e dialogjeve ndërfaqësore dhe të projekteve të shërbimit në komunitet që përfshijnë grupe të ndryshme fetare që punojnë së bashku.

Në këtë frymë, unë shpresoj për një të ardhme ku bashkëjetesa multietnike në Kosovë do të bëhet normë. Unë parashoh komunitete ku dallimet etnike dhe fetare merren si anë të forta, jo si burime ndarjesh. Për këtë qëllim, ju mund të përqendrohemi në krijimin e programeve të qëndrueshme që edukojnë për diversitet kulturor dhe tolerancë, mbështesin projekte të përbashkëta të komunitetit, dhe sigurojnë përfaqësim të barabartë të të gjitha grupeve etnike dhe fetare në qeverisjen lokale.

Për këtë arsye ju inkurajoj të merrni pjesë aktive në krijimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës, duke mbështetur nisma ndërfaqësore, duke përkrahur politika që garantojnë mundësi të barabarta për të gjithë, dhe duke nxitur dialogun e hapur dhe me respektim midis grupeve të ndryshme etnike dhe fetare.

E përfundoj këtë letër me një vërejtje shpresëdhënëse, duke parashikuar një të ardhme ku përpjekjet tona të bashkuara do ta kultivojnë një shoqëri vërtet harmonike dhe multietnike në Kosovë. Jam i sigurtë se me përkushtimin tonë të përbashkët, ne mund të arrijmë përparim të jashtëzakonshëm drejt këtij qëllimi të merituar.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Sinqerisht,

Dimitrije Obrenović

**Mentor Agani, Hulumtues i Lartë
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave
Prishtinë, Kosovë**

I nderuari Myfti Naim Tërnavë,

Unë jam Mentor Agani, dhe jam Hulumtues i Lartë në KIPRED, Instituti Kosovar për Hulimtim dhe Zhvillim të Politikave, si dhe ligjërues në Kolegjin Dardania në Prishtinë. Gjatë periudhës 2003-2016 kam qenë po ashtu edhe ligjërues në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Këtë letër po e shkruaj me synimin për t'i shprehur disa nga pritjet dhe dëshirat e mia lidhur me bashkëjetesën ndëretnike në Kosovë.

Mendoj se Ju dhe Bashkësia Islame e Kosovës mund ta jipni një kontribut të rëndësishëm dhe të çmuar drejt normalizimit të marrëdhënieve etnike në Kosovë. Jam i bindur se paraqitja e qenies njerëzore, pavarësisht nga përkatësia etnike, si krijesa më e lartë e Zotit, pra si vlera më e lartë në shoqëri, është në përputhje të plotë me mësimet e Islamit. Prandaj, mendoj se Bashkësia Islame e Kosovës duhet të organizohet për ta krijuar një strategji për promovimin e kësaj ideje në predikimet e imamëve të saj, pra, atë të qenies njerëzore si vlera supreme shoqërore, pavarësisht nga përkatësia e vet etnike. Jam i bindur se shumë besimtarë islamikë në Kosovë, të cilët do të mund të ishin të prirur kah pasionet nacionaliste, do të ndryshonin qëndrim nëse do të kishin mundësi të dëgjonin predikimet e imamëve të Bashkësisë Islame të Kosovës për të respektuar dhe vlerësuar anëtarët e etnive të tjera si qenie njerëzore dhe krijesa të Zotit.

Unë po ashtu besoj se normalizimi i marrëdhënieve midis komunitetit shqiptar dhe atij serb të Kosovës mund të jetë një synim që mund të theksohet dhe të mbështetet në predikimet e imamëve kosovarë. Artikulimi i paqes, tolerancës, respektit dhe bashkëpunimit midis grupimeve të ndryshme shoqërore me siguri se është një qëllim që lavdërohet nga Islami. Prandaj, duhet gjetur mënyra që në predikimet e imamëve të përfshihen edhe vlerat dhe përfitimet e përmirësimit të marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë, dhe posaçërisht të atyre midis shqiptarëve dhe serbëve.

Edhe një çështje tjetër që dua ta përmend është ajo e gjendjes së Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë. Për shkak të pasioneve politike dhe nacionaliste kjo kishë është e izoluar dhe e shpërfillur nga institucionet e feve tjera të Kosovës. Prandaj, mendoj se institucionet fetare të të gjitha feve që kanë anëtarësi shqiptare (Islami, Katolicizmi, Protestantizmi, etj.), duhet të organizohen bashkërisht për t'i vizituar së bashku institucionet fetare të Kishës Ortodokse Serbe me rastin e kremteve të tyre fetare, me qëllim që t'i përgëzojnë për ato festa. Kjo me siguri se do t'i zbuste marrëdhëniet midis feve, njësoj si dhe midis bashkësive etnike në Kosovë. Pranimi i serbëve nga ana e Kosovës është kusht i domosdoshëm për pranimin e Kosovës nga ana e serbëve, ndërkaq pranimi fetar i Kishës Ortodokse Serbe nga fetet e tjera në Kosovë është një hap i rëndësishëm dhe i domosdoshëm drejt këtij qëllimi.

Duke ndihmuar zbutjen e tendosjeve dhe të problemeve ndër-etnike, institucionet e Bashkësisë Islame të Kosovës gjithsesi do ta jipnin një kontribut shumë të madh për ta bërë Kosovën një vend më të mirë në të ardhmen.

Ju falemnderit, dhe përshëndetjet më të përzemërta,

Mentor Agani

Zoran Savič, Koordinator i Projekteve
NGO AKTIV
Mitrovicë e Veriut, Kosovë

I dashuri Myfti, Naim ef. Tërnavë,

Quhem Zoran Savič dhe jam koordinator i projekteve në organizatën joqeveritare Aktiv të Mitrovicës së Veriut. Edhe pse jam lindur në Pulë të Kroacisë, unë në të vërtetë kam jetuar në Mitrovicë për 30 vite dhe jam i përfshirë aktivisht në jetën shoqërore të Kosovës, si përmes punës, ashtu edhe përmes jetës kulturore, duke pasur parasysh se jam edhe muzikant dhe kam marrë pjesë në projekte të shumta ndëretnike me muzikantë të kombësisë shqiptare.

Në të njëjtën kohë, për shumë vite kam punuar si gazetar në portalin Kosova Sever – KoSSev, dhe përmes kësaj pune u njoha edhe më nga afër me situatën politike, të sigurisë dhe atë fetare në Kosovë. Unë edhe sot bashkëpunoj me gazetarë dhe redaktorë të shumtë shqiptarë, si në aspektin e projekteve, ashtu edhe përmes punëve që nuk janë të ndërlidhura me to.

Udhëheqja juaj si Kryetar i Bashkësisë Islame të Kosovës mund ta promovojë në një masë të madhe harmoninë ndëretnike. Inkurajimi i dialogut dhe bashkëpunimit midis grupeve të ndryshme fetare dhe etnike mund të ndihmojë në kapërcimin e ndarjeve. Ju thërras t'i mbështesni programet e komunitetit dhe projektet e shërbimeve të përbashkëta që bashkojnë njerëz me prejardhje të ndryshme. Predikimet dhe fjalimet tuaja publike mund ta theksojnë unitetin, tolerancën dhe respektimin e të gjithëve. Prandaj, unë në të ardhmen pres mbështetjen tuaj në organizimin e dialogut ndëretnik dhe të projekteve në shërbim të komunitetit që përfshijnë grupe të ndryshme fetare që punojnë së bashku.

Në këtë frymë, shpresoj për një të ardhme ku bashkëjetesa multi-etnike fetare në Kosovë do të shndërrohet në normë. Unë parashikoj komunitete ku dallimet fetare merren si anë të forta dhe jo si burime ndarjeje. Për këtë qëllim, ju mund të përqendrohemi në krijimin e programeve të qëndrueshme që edukojnë për diversitetin dhe tolerancën fetare, që mbështesin projekte të përbashkëta të komunitetit, dhe që sigurojnë përfaqësim të barabartë të të gjitha grupeve fetare në qeverisjen lokale.

Po e përfundoj këtë letër me një vërejtje shpresëdhënëse, duke parashikuar një të ardhme ku përpjekjet tona të bashkuara do ta kultivojnë një shoqëri vërtet harmonike dhe multi-etnike në Kosovë. Jam i sigurtë se me përkushtimin tonë të përbashkët, ne mund ta arrijmë një përparim të jashtëzakonshëm drejt këtij qëllimi të çmuar.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Zoran Savič



Letrat e Dëshirave dhe Pritjeve

Leonora Kryeziu, Jovana Radosavljević, Robert Muharremi, Dušan Radaković, Ilir Deda, Senad Sabović, Ramadan Ilazi, Dimitrije Obrenović, Mentor Agani dhe Zoran Savić

SH.T. Imzot Dodë Gjergji, Ipeshkëv
Administrator Apostolik i Kosovës

Korrik 2024

**Leonora Kryeziu, Drejtoreshë Ekzekutive
Instituti i Prishtinës për Studime Politike
Prishtinë, Kosovë**

I nderuar Ipeshkëv Gjergji,

Unë jam Leonora Kryeziu, banore e Prishtinës, e lindur në vitin 1971. Duke qenë se i takoj një gjenerate që fëmijërinë dhe rininë e kam kaluar në ish-Jugosllavi, mbaj mend mirë se si dukej bashkëjetesa multi-etnike në Prishtinë, me ngjyrimet e veta sa të errëta, po aq edhe të bukura, të një bashkëjetese deri diku të qetë.

Me këtë letër, dua t'i ndaj me ju pritjet dhe dëshirat e mia personale lidhur me promovimin e kohezionit social ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij serb në kryeqytet, dhe jo vetëm duke përmendur shembuj të së kaluarës por edhe mundësitë që na i ofron e tashmja.

Lidhur me komunitetin katolik, e vlerësoj thellësisht rolin që ju e keni në promovimin e unitetit dhe të kuptimit reciprok midis grupeve të ndryshme etnike dhe fetare. Në një shoqëri shpesh herë të ndarë përmes vijave etnike, besoj se liderët fetarë kanë fuqi për t'i bashkuar njerëzit dhe për t'i frymëzuar ata drejt paqes dhe harmonisë.

Në transmetimin e mesazheve të tolerancës dhe paqes, duke inkurajuar besimtarët tuaj që këto vlera t'i pranojnë si të rëndësishme për bashkëjetesën tonë, roli juaj është shumë i rëndësishëm. Nismat e përbashkëta humanitare dhe programet e shërbimit në komunitet mund të ndihmojnë në tejkalimin e ndarjeve dhe në kultivimin e solidaritetit midis komuniteteve shqiptare dhe serbe. Duke u angazhuar në aktivitete të tilla të përbashkëta, ne mund të ndërtojmë marrëdhënie të bazuara në dashamirësi dhe në vlerësim reciprok.

Duke ju falenderuar për vëmendjen, shpreh shpresën se së bashku mund ta krijojmë një shoqëri ku çdo banor, pa e marrë parasysh etninë apo origjinën, do të ndihet i vlerësuar dhe i respektuar. Besoj në vullnetin tonë të përbashkët për ta ndërtuar një shoqëri harmonike për brezat e ardhshëm.

Me respekt,

Leonora Kryeziu

Jovana Radosavljević, Drejtoreshë Ekzekutive
New Social Initiative
Mitrovicë e Veriut, Kosovë

I dashuri Ipeshkëv Gjergji,

Shpresoj që kjo letër do t'ju gjejë mirë. Unë quhem Jovana Radosavljević, dhe jam një aktiviste serbe e Kosovës e shoqërisë civile nga Mitrovica e Veriut, që punon në përpjekjet për pajtimin midis serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës. Jam duke ju shkruar si pjesë e Karvanit Multi-etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë për të ndarë pritjet dhe dëshirat e mia për bashkëjetesën multi-etnike në Kosovë.

Udhëheqja juaj në Dioqezën Prizren-Prishtinë në një masë të madhe mund ta promovojë harmoninë ndëretnike. Inkurajimi i dialogut dhe bashkëpunimit midis grupeve të ndryshme fetare dhe etnike mund të ndihmojë në kapërcimin e ndarjeve. Ju nxis që t'i mbështesni programet e komunitetit dhe projektet e shërbimeve të përbashkëta që bashkojnë njerëz me prejardhje të ndryshme. Predikimet dhe fjalimet tuaja publike mund ta theksojnë unitetin, tolerancën dhe respektin për të gjithë.

Duke shikuar përpara, unë e parashoh një Kosovë ku bashkëjetesa multi-etnike dhe toleranca janë të përvetësuar. Takimet e rregullta ndër-fetare dhe nismat ndërkulturore mund ta nxisin dialogun dhe bashkëpunimin.

Në përfundim, ju inkurajoj t'i vazhdoni përpjekjet tuaja për ndërtimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës. Udhëheqja juaj mund t'i frymëzojë të tjerët për ta krijuar një të ardhme ku në Kosovë të gjithë do të ndihen si në shtëpinë e vet.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Sinqerisht,

Jovana Radosavljević

Dr. Robert Muharremi
Fred C. Cuny Center for Peace and Conflict Studies
Rochester Institute of Technology in Kosovo
Prishtinë, Kosovë

I dashuri I peshkëv Dodë Gjergji,

Fuqia e Kosovës qëndron në diversitetin e saj etnik dhe fetar, dhe zëri juaj ka peshë të madhe në nxitjen e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndërmjet të gjitha komuniteteve. Ju nxis ta vazhdoni punën tuaj të paçmuar dhe t'i hetoni nismat e mëtutjeshme që mund ta bëjnë një ndryshim të mirëfilltë për të mirën e të gjitha komuniteteve në Kosovë. Përndryshe, Qendra Fred C. Cuny për Studime të Paqes dhe Konfliktëve në Institutin Rochester të Teknologjisë në Kosovë ofron një platformë akademike për studimin dhe mësimin e shkaqeve, të praktikave dhe të pasojave të luftës dhe dhunës politike, si dhe të metodave të menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktëve. Hulumtimi jonë ndihmon akademikët, qeveritë, praktikuesit dhe shoqërinë civile për ta kuptuar natyrën e konfliktit dhe për t'i formuluar politikat efektive të zgjidhjes. Qendra jonë është në krye të bashkimit të qendrave kërkimore dhe të organizatave të shoqërisë civile që përfaqësojnë komunitetet e ndryshme të Kosovës dhe nxisin një klimë të mirëkuptimit dhe të tolerancës së ndërsjellë.

Jam duke ju shkruar për ta shprehur mbështetjen e plotë, si timen, ashtu edhe të Qendrës sonë, për nismën e Karvanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë. Kosova është një shoqëri multi-etnike, demokratike dhe pluraliste, dhe besoj se respektimi i Kushtetutës së Kosovës, e cila i ruan këto vlera dhe orientimin euroatlantik të Kosovës, nuk është vetëm kritik, por është edhe vetë thelbi i asaj që Kosova përfaqëson.

Shpresoj se do ta promovoni tolerancën etnike dhe fetare përmes programeve ndërfetare që inkurajojnë dialogun dhe bashkëpunimin, dhe posaçërisht midis të rinjve me prejardhje të ndryshme. Kjo do të mbjellë farat e tolerancës dhe të mirëkuptimit për brezat e ardhshëm. Meqenëse zëri juaj ka fuqi të madhe, lëshimi i deklaratave publike që dënojnë aktet e mostolerancës dhe që promovojnë bashkëpunimin ndërfetar do të dërgonte një mesazh të fortë uniteti dhe do t'i frymëzonte të tjerët ta ndjekin shembullin. Duke zbatuar aktivitete të tilla, ju mund ta forconi edhe më tej rolin e komunitetit katolik si kampion i tolerancës fetare dhe etnike në Kosovë. Lidërshipi juaj i vazhdueshëm do të jetë i dobishëm në ndërtimin e një Kosove më të fortë dhe më përfshirëse për të gjithë.

Shpresoj se do të shoh se jemi duke u përpjekur së bashku për një shoqëri ku shqiptarët dhe serbët dhe të gjitha komunitetet e tjera do të jetojnë së bashku në harmoni, me mirëkuptim dhe respektim të ndërsjellë.

Jam i bindur se mund ta krijojmë një shoqëri paqësore dhe përfshirëse ku diversiteti në shtetin tonë multi-etnik do të lartësohet dhe ku çdo individ do të ndjehet i vlerësuar dhe i respektuar.

Ju falemnderit për përkushtimin tuaj për këtë kauzë fisnike.

Sinqerisht,

Dr. Robert Muharremi

**Dušan Radaković, Drejtor Ekzekutiv
Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC)
Mitrovicë e Veriut, Kosovë**

I dashuri Ipeshkëv Dode Gjergji,

Unë quhem Dušan Radaković, dhe jam Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC - Advocacy Center for Democratic Culture). I lindur në vitin 1984 në Mitrovicë, unë kam qenë thellësisht i përkushtuar për nxitjen e dialogut dhe bashkëpunimit ndëretnik që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë. Gjatë viteve kam marrë pjesë në nisma të shumta multietnike, duke punuar së bashku me organizata të ndryshme ndërkombëtare për të promovuar paqen dhe mirëkuptimin ndërmjet komuniteteve të ndryshme.

Me Gradën Master në Drejtësi, dhe me një përvojë të madhe në shoqërinë civile, përfshirë rolet në media dhe në menaxhimin e projekteve, unë karrierën time ia kam kushtuar përkrahjes së vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut. Qëllim i kësaj letre times është t'i ndaj pritjet dhe dëshirat e mia personale lidhur me përparimin e bashkëjetesës multietnike në Kosovë, si pjesë e Karvanit Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë.

Si një udhëheqës fetar kyç, roli juaj në nxitjen e respektimit dhe të mirëkuptimit të ndërsjellë midis komuniteteve fetare është jetik. Shpresoj se do të avokoni për programe arsimore që mësojnë tolerancën dhe pranimin.

Dëshira ime është ta shoh një të ardhme ku bashkëjetesa multietnike në Kosovë është normë. Unë i përfytyroj komunitetet ku dallimet etnike dhe fetare lartësohen si anë të forta, jo si burime ndarjeje. Në këtë drejtim, synimet afatgjata mund ta përfshijnë krijimin e programeve të qëndrueshme që promovojnë edukimin mbi diversitetin kulturor, mbështetjen e projekteve të përbashkëta të komunitetit dhe sigurimin e përfaqësimit të barabartë të të gjitha grupeve etnike dhe fetare në qeverisjen lokale.

Prandaj, ju bëj thirrje që të angazhoheni aktivisht në ndërtimin e një komuniteti paqësor dhe gjithëpërfshirës duke mbështetur nismat ndëretnike, duke promovuar politika që sigurojnë mundësi të barabarta për të gjithë, dhe duke inkurajuar dialogun e hapur dhe me respektim midis grupeve të ndryshme etnike dhe fetare.

E përfundoj këtë letër me një shënim pozitiv, duke shprehur shpresën time për një të ardhme më të ndritur ku përpjekjet tona kolektive do të çojnë në një shoqëri vërtet harmonike dhe multietnike në Kosovë. Unë kam besim se me angazhimin tonë të përbashkët ne mund të bëjmë hapa të rëndësishëm drejt kësaj kauze fisnike.

Përshëndetje të përzemërta,

Dušan Radaković

**Ilir Deda,
Aktivist i Shoqërisë Civile
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Ipeshkëv Gjergji,

Për më shumë se dy dekada me radhë, unë kam qenë i përfshirë dhe i angazhuar në role të ndryshme në çështjet kyçe për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor, përfshirë këtu edhe ruajtjen dhe përparimin e diversitetit në vendin tonë.

Qëllim i kësaj letre është t'i shikojë mundësitë për ta zgjeruar përfshirjen tuaj në promovimin e Prishtinës si një qytet të hapur për të gjithë njerëzit, që përfshin bashkëjetesën multietnike dhe multifetare në kryeqytetin tonë. Kjo është posaçërisht e rëndësishme në këtë kohë kur qëndrimet populliste dhe përjashtuese janë duke fituar hapësirë.

Harmonia ndërjetare ka qenë një nga vlerat thelbësore të kombit tonë, dhe Dioqeza Prizren-Prishtinë e ka një rol qendror për ruajtjen dhe promovimin e kësaj vlere. Unë besoj se janë disa veprime afatshkurtra dhe disa afatgjata që ju mund t'i ndërmerrni dhe që ato t'i shndërroni në praktika. Disa prej tyre burojnë nga praktikatat e mëparshme.

Në të kaluarën, ekzistonte një praktikë ku udhëheqësit fetarë njëri-tjetrit ia uronin publikisht festat më të rëndësishme fetare. Rivendosja e kësaj praktike, edhe pse simbolike, do të ishte një hap fillestar drejt avancimit të respektit ndërjetar në vendin tonë. Kjo do ta nënkuptonte respektimin e festave më të rëndësishme fetare për pjesëtarët e komuniteteve islame, protestante dhe ortodokse.

Dialogu ndërjetar dhe mirëkuptimi më i madh është një formë moderne që synon avancimin e bashkëjetesës dhe të harmonisë ndërjetare. Edhe pse jetojmë në një kohë kur harmonia nuk është duke u vlerësuar, unë besoj se Kosova, duke pasur parasysh historinë e saj unike, mund ta vendosë një dialog ndërjetar në nivelin lokal komunal, për ta filluar krijimin e kulturës së paqes. Ky forum do ta çonte përpara mirëkuptimin e ndërsjellë midis udhëheqësve fetarë lokalë, duke përfshirë këtu edhe mirëkuptimin me autoritetet komunale lokale. Ai do të shërbente po ashtu edhe si një forum për t'i diskutuar dhe adresuar nevojat përkatëse të çdonjërit nga komunitetet fetare.

Së fundi, vizita te krerët fetarë ortodoksë lokalë do ta kishte një ndikim domethënës në avancimin e bashkëjetesës paqësore ndëretnike në vendin tonë. Kosova do të jetë e suksesshme vetëm nëse e ruan karakterin e saj multietnik dhe Dioqeza Prizren-Prishtinë ka një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe avancimin e këtij karakteri të shtetit tonë.

Unë besoj fuqishëm se udhëheqja juaj është kritike në këtë pikë të zhvillimit të vendit tonë dhe shpreh shpresën se do të merrni parasysh veprimet e propozuara.

Përsëritet më të sinqerta,

Ilir Deda

**Senad Šabović, Këshilltar i Lartë
Instituti Evropian për Paqe
Bruksel – Prishtinë**

I nderuari Ipeshkëv Gjergji,

Unë quhem Senad Šabović, dhe po Ju shkruaj si përkrahës i projektit të quajtur Karvani Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë. Unë punoj si Këshilltar i Lartë në Institutin Evropian për Paqe, me përqendrimin kryesor në mbështetjen e Dialogut të ndihmuar nga BE-ja dhe të procesit të normalizimit në përgjithësi. Organizata ime është pjesë e një koalicioni të shoqërisë civile të quajtur Alternativa Qytetare e Kosovës (AKK), e cila përpiqet ta japë një kontribut konkret në këtë fushë.

Kjo letër synon t'i shprehë pritjet e mia nga Ju sa i përket multietnicitetit dhe bashkëjetesës. Siç dimë, Republika e Kosovës përkufizohet si shtet multietnik i të gjithë qytetarëve dhe komuniteteve të saj. Këto parime janë të rrënjësura thellë në sistemin kushtetues dhe ligjor të Kosovës. Ato po ashtu vazhdojnë të jenë edhe pritja kryesore e partnerëve tanë perëndimorë dhe e sistemit organizativ të komunitetit euroatlantik, hyrjen në të cilin ne e aspirojmë. Si të tilla, parimet e multietnicitetit, mirëkuptimit dhe të bashkëjetesës paqësore duhet të pasqyrohen plotësisht në jetën fetare të vendit tonë. Në këtë drejtim është bërë punë e madhe, por ajo duhet të forcohet dhe të zgjerohet edhe më tutje, dhe posaçërisht në këtë kohë të shtimit të tendosjeve dhe të ngecjes së normalizimit. Me kalimin e viteve, me një vlerësim të lartë i kam vënë re disa nga kontributet Tuaja në këtë drejtim. Poaçërisht mbresëlënëse kanë qenë angazhimet tuaja me udhëheqësit dhe përfaqësuesit e Besimeve të tjera të pranishme në Kosovë dhe udhëheqja juaj në kontekstin e kornizave të ndryshme të dialogut ndërfaqetor dhe të nismave të ndryshme praktike të bashkëpunimit ndërfaqetor.

Unë dhe kolegët e projektit dëshirojmë t'ju inkurajojmë për t'i zgjeruar këto nisma, si dhe t'i ofrojmë disa sugjerime në këtë drejtim. Përgjithësisht, shfrytëzimi i mundësive të ofruara për ta theksuar multietnicitetin si vlerë është jashtëzakonisht i dobishëm. Kjo mund të përfshijë njoftime të përbashkëta për shtyp, përmbajtje të mediave sociale ose vizita të përbashkëta me udhëheqës të ndryshëm fetarë ose institucionalë në qendra dhe vende të rëndësishme komunitare. Theksimi i mesazheve të Biblës së Shenjtë për tolerancën dhe respektimin, sipas rastit, në angazhimet e Dioqezës suaj me besimtarët do të ishte po ashtu një mënyrë efektive për të kontribuar.

Më konkretisht, Ju, së bashku me udhëheqësit e feve të tjera të tjera të Kosovës, mund ta ndërmerreni nismën për krijimin e një këshilli ndërfaqetor, i cili do ta koordinonte dhe këshillonte shtetin dhe donatorët ndërkombëtarë për mbrojtjen dhe rehabilitimin e objekteve të cënueshme fetare në mbarë Kosovën. Kjo jo vetëm që do të përmirësonte mirëqenien fizike të këtyre vendeve, por po ashtu do të rikonfirmonte vazhdimisht mesazhin e tolerancës dhe respektit, që është aq integral për besimin katolik, si në Kosovë ashtu edhe anembanë botës.

I nderuari peshkop, mund të jini të sigurtë se kolegët e mi nga Instituti Evropian i Paqes, nga ky projekt, si dhe nga koalicioni i përmendur i OAK-së, do të jemi më se të gatshëm për t'ju ofruar mbështetje konkrete, Juve dhe udhëheqësve të tjerë fetarë në zbatimin e sugjerimeve të parapara këtu.

Me respekt të lartë,

Senad Šabović

**Ramadan Ilazi, Udhëheqës i Hulumtimeve
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Ipeshkëv Dodë Gjergji,

Quhem Ramadan Ilazi, dhe aktualisht jam udhëheqës i hulumtimeve në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Me një prapavijë në studimet për paqe dhe konflikte, me Diplomë Master nga Universiteti St. Andrews, dhe Doktoraturë nga Universiteti i Qytetit të Dublinit (DCU), unë karrierën time ia kam kushtuar promovimit të Kosovës si një shoqëri demokratike dhe e shumëllojshme. Rolet e mia kanë përfshirë të qenit aktivist, udhëheqjen e organizatave, dhe shërbimin si Zëvendësministër për Integritet Evropian.

Kushtetuta e Kosovës fillon me vizionin e ndërtimit të një të ardhmeje si një vend i lirë, demokratik dhe paqedashës i të gjithë qytetarëve të saj. Ky vizion është thelbësor, dhe realizimi i tij është përgjegjësi jona kolektive. Në qendër të këtij vizioni është ideja që Kosova është shtëpia e të gjithë qytetarëve të saj, të cilët duhet ta kenë ndjenjën e përkatësisë dhe të krenarisë.

Komuniteti Katolik në Kosovë ka një traditë të gjatë dhe krenare në promovimin e paqes dhe në shërbimin e komunitetit, dhe posaçërisht në kohë nevojash të mëdha. Mesazhet e Nënë Terezës, që theksojnë dashurinë, dhembshurinë dhe shërbimin ndaj të tjerëve, kumbojnë thellë me vlerat që ne përpiqemi t'i mbajmë. Këto mesazhe duhet të vazhdojnë t'i frymëzojnë përpjekjet tona për ta nxitur një shoqëri harmonike dhe përfshirëse. Si Administrator i Dioqezës Prizren - Prishtinë, udhëheqja juaj është vendimtare në promovimin e harmonisë ndëretnike dhe ndërfetare. Ju inkurajoj të vazhdoni të avokoni për paqen dhe respektimin e ndërsjellë përmes nismave të Kishës dhe angazhimit të komunitetit. Organizimi i dialogjeve ndërfetare, i projekteve të përbashkëta të shërbimit në komunitet, dhe i ngjarjeve të shkëmbimit kulturor, mund t'i kontribuojë ndjeshëm ndërtimit të urave midis grupeve të ndryshme etnike dhe fetare.

Për më tepër, unë propozoj takime të rregullta të të gjithë udhëheqësve fetarë në Kosovë për ta nxitur dialogun dhe bashkëpunimin. Këto takime mund të rezultojnë në deklarata dhe nisma të përbashkëta që nxisin unitet dhe mirëkuptim. Përpjekjet e tilla mund të shërbejnë si një shembull i fuqishëm për të gjithë qytetarët dhe ta forcojnë vizionin e një shoqërie paqësore dhe kohezive. Më konkretisht, sugjeroj që Kisha Katolike e Kosovës ta organizojë një festival për ta lartësuar diversitetin e Kosovës në Kishën e Madonës së Zezë në Letnicë. Ky festival mund të bashkojë përfaqësues të të gjitha bashkësive etnike dhe fetare në Kosovë, duke shfaqur traditat e tyre, ushqimin, muzikën, etj. Një ngjarje e tillë jo vetëm që do ta nxirrte në shesh mozaikun tonë të pasur kulturor, por do ta nxiste po ashtu edhe respektimin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë midis grupeve të ndryshme.

Duke organizuar ngjarje që lartësojnë diversitetin kulturor dhe etnik të Kosovës, ne mund ta krijojmë një model të bashkëjetesës që do t'i frymëzojë rajonet e tjera. Unë kam shpresë dhe besim në angazhimin tuaj për këtë kauzë. Udhëheqja juaj, e drejtuar nga parimet e paqes dhe të shërbimit, mund ta frymëzojë një të ardhme ku diversiteti i Kosovës festohet si burim i forcës dhe unitetit.

Ju falemnderit,

Ramadan Ilazi

Dimitrije Obrenović,
Koordinator i Projekteve,
NGO Aktiv
Mitrovica e Veriut, Kosovë

I dashuri Ipeshkëv Gjergji,

Qhem Dimitrije Obrenović, dhe jam aktivist për të drejtat e njeriut dhe koordinator i projekteve në OJQ-në Aktiv, dhe jetoj në Mitrovicën e Veriut. Unë përpiqem për të drejta të barabarta të njeriut dhe për nxitje të bashkëpunimit ndërfaqetare më të mirë, duke besuar fuqimisht se për një të ardhme më të mirë kërkohet bashkëpunim i mëtutjeshëm.

Udhëheqja juaj në Dioqezën Prizren-Prishtinë mund ta promovojë në një masë të madhe harmoninë ndërfaqetare. Inkurajimi i dialogut dhe bashkëpunimit midis grupeve të ndryshme fetare dhe etnike mund të ndihmojë në kapërcimin e ndarjeve. Ju thërras që t'i mbështesni programet e komunitetit dhe projektet e shërbimeve të përbashkëta që bashkojnë njerëz me prejardhje të ndryshme. Predikimet dhe fjalimet tuaja publike mund ta theksojnë unitetin, tolerancën dhe respektimin e të gjithëve.

Duke shikuar përpara, unë e parashoh një Kosovë që e përvetëson bashkëjetesën multietnike dhe tolerancën fetare. Takimet e rregullta ndërfaqetare dhe nismat ndërkulturore mund të nxisin dialog dhe bashkëpunim.

Në përfundim, ju inkurajoj t'i vazhdoni përpjekjet tuaja në ndërtimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës. Udhëheqja juaj mund t'i frymëzojë të tjerët për ta krijuar një të ardhme ku në Kosovë të gjithë do të ndjehen si në shtëpinë e vet.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Sinqerisht,

Dimitrije Obrenović

**Mentor Agani, Hulumtues i Lartë
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave
Prishtinë, Kosovë**

I nderuari Ipeshkëv Dodë Gjergji,

Unë jam Mentor Agani, dhe jam Hulumtues i Lartë në KIPRED, Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave, si dhe ligjërues në Kolegjin Dardania në Prishtinë. Gjatë periudhës 2003-2016 kam qenë po ashtu edhe ligjërues në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Këtë letër po e shkruaj me synimin për t'i shprehur disa nga pritjet dhe dëshirat e mia lidhur me bashkëjetesën ndëretnike në Kosovë, dhe për t'i përmendur disa veprime që mund të ndërmerren lidhur me këtë.

Jam i bindur se Ju dhe institucionet e Kishës Katolike në Kosovë mund ta jepni një kontribut të rëndësishëm drejt normalizimit të marrëdhënieve etnike në Kosovë. Sigurisht se ka shumë aspekte të predikimeve fetare që janë në përputhje të plotë me qëllimin politik për përmirësimin e marrëdhëniet etnike në Kosovë, dhe posaçërisht të atyre midis komuniteteve shqiptare dhe serbe. Dhe unë pres që në mesin e institucioneve të Kishës Katolike të Kosovës të ketë një përpjekje për ta vënë një përqendrim të posaçëm në pikërisht ato aspekte në predikimet e priftërinjve të saj.

Për shembull, paraqitja dhe trajtimi i qenies njerëzore, pavarësisht nga përkatësia e saj etnike, si krijesa më e lartë e Zotit, dhe, rrjedhimisht, si vlera më e lartë shoqërore, është sigurisht një aspekt i tillë që mund të theksohet në predikimet e priftërinjve katolikë. Promovimi i kësaj ideje te besimtarët, jo si qëllim politik, por si vlerë dhe virtyt fetar, me siguri se do të ishte një kontribut i rëndësishëm në përmirësimin e marrëdhënieve etnike në Kosovë. Unë besoj se shumë besimtarë të prirur drejt nacionalizmit do ta ndryshonin qëndrimin e tyre nëse priftërinjtë (a imamët) e tyre në predikimet e veta do të përqendroheshin në faktin se urrejtja kundër anëtarëve të etnive të tjera është urrejtje kundër krijesave të Zotit. Një përqendrim tjetër i predikimeve mund të jetë promovimi i paqes, tolerancës, respektit dhe bashkëpunimit ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike, dhe posaçërisht midis shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës. Paqja, toleranca, respektimi dhe bashkëpunimi midis grupimeve të ndryshme njerëzore janë padyshim qëllime të lavdëruara nga katolicizmi dhe ato duhet të përfshihen sa më shumë në predikimin e priftërinjve të tij.

Një çështje e rëndësishme këtu është ajo e marrëdhënieve ndërmjet bashkësive të ndryshme fetare kosovare dhe institucioneve fetare të Kishës Ortodokse Serbe. Mendoj se institucionet fetare të të gjitha feve që kanë anëtarësi shqiptare (Katolicizmi, Islami, Protestantizmi, etj.), duhet të organizohen dhe t'i vizitojnë së bashku autoritetet dhe institucionet fetare të Kishës Ortodokse Serbe me rastin e kremtimeve të tyre fetare, me qëllim që t'ua urojnë festat. Pranimi i serbëve nga ana e Kosovës është kusht i domosdoshëm për pranimin e Kosovës nga ana e serbëve, dhe pranimi fetar i Kishës Ortodokse Serbe nga ana e feve të tjera në Kosovë është një hap i rëndësishëm drejt këtij qëllimi.

Duke ndihmuar zbutjen e tendosjeve dhe problemeve ndëretnike, institucionet e Kishës Katolike të Kosovës gjithsesi do ta japin një kontribut të jashtëzakonshëm për ta bërë Kosovën një vend më të mirë në të ardhmen.

Ju falemnderit, dhe përshëndetje të përzemërta

Mentor Agani

Zoran Savič, Koordinator i Projekteve
NGO AKTIV
Mitrovicë e Veriut, Kosovë

I dashur Ipeshkëv Dodë Gjergji,

Quhem Zoran Saviç dhe jam koordinator i projekteve në organizatën joqeveritare Aktiv të Mitrovicës së Veriut. Edhe pse jam lindur në Pulë të Kroacisë, unë në të vërtetë kam jetuar në Mitrovicë për 30 vite dhe jam i përfshirë aktivisht në jetën shoqërore të Kosovës, si përmes punës, ashtu edhe përmes jetës kulturore, duke pasur parasysh se jam edhe muzikant dhe kam marrë pjesë në projekte të shumta ndëretnike me muzikantë të kombësisë shqiptare.

Në të njëjtën kohë, për shumë vite kam punuar si gazetar në portalin Kosova Sever – KoSSev, dhe përmes kësaj pune u njoha edhe më nga afër me situatën politike, të sigurisë dhe atë fetare në Kosovë. Unë edhe sot bashkëpunoj me gazetarë dhe redaktorë të shumtë shqiptarë, si në aspektin e projekteve, ashtu edhe përmes punëve që nuk janë të ndërlidhura me to.

Udhëheqja juaj e Dioqezës Prizren-Prishtinë mund ta promovojë në një masë të madhe harmoninë ndëretnike. Inkurajimi i dialogut dhe bashkëpunimit midis grupeve të ndryshme fetare dhe etnike mund ta ndihmojë kapërcimin e ndarjeve. Ju thërras për t'i mbështetur programet e komunitetit dhe projektet e shërbimeve të përbashkëta që bashkojnë njerëz me prejardhje të ndryshme. Predikimet dhe fjalimet tuaja publike mund ta theksojnë unitetin, tolerancën dhe respektimin e të gjithëve. Prandaj, në të ardhmen pres mbështetjen tuaj në organizimin e dialogut ndëretnik dhe të projekteve në shërbim të komunitetit që përfshijnë grupe të ndryshme fetare që punojnë së bashku.

Në këtë frymë, unë shpresoj për një të ardhme ku bashkëjetesa multietnike fetare në Kosovë do të jetë normë. Unë parashoh komunitete ku dallimet fetare merren si anë të forta dhe jo si burime ndarjeje. Për këtë qëllim, ju mund të përqendrohemi në krijimin e programeve të qëndrueshme që edukojnë për diversitet dhe tolerancë fetare, që mbështesin projekte të përbashkëta të komunitetit, dhe që sigurojnë përfaqësim të barabartë të të gjitha grupeve fetare në qeverisjen lokale.

Duke shikuar përpara, unë e shoh një Kosovë ku bashkëjetesa multietnike dhe toleranca fetare janë të përvetësuar. Takimet e rregullta ndërfitare dhe nismat ndërkulturore mund të nxisin dialog dhe bashkëpunim.

Po e përfundoj këtë letër me një vërejtje shpresëdhënëse, duke parashikuar një të ardhme ku përpjekjet tona të bashkuara do ta kultivojnë një shoqëri vërtet harmonike dhe multietnike në Kosovë. Jam i sigurt se me përkushtimin tonë të përbashkët ne mund ta arrijmë një përparim të jashtëzakonshëm drejt këtij qëllimi të çmuar.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Zoran Saviç



Letrat e Dëshirave dhe Pritjeve

Leonora Kryeziu, Jovana Radosavljević, Robert Muharremi, Dušan Radaković, Ilir Deda, Senad Sabović, Ramadan Ilazi, Dimitrije Obrenović, Mentor Agani dhe Zoran Savić

Kryepriifti Staniša Arsić
Kisha Ortodokse Serbe e Shën Nikollës në Prishtinë

Korrik 2024

**Leonora Kryeziu, Drejtoreshë Ekzekutive
Instituti i Prishtinës për Studime Politike
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Kryepriift Arsić,

Unë jam Leonora Kryeziu, banore e Prishtinës e lindur në vitin 1971. E rritur në një mjedis të bashkëjetesës multietnike të ish-Jugosllavisë, kujtoj me dashuri komunitetin e larmishëm dhe të gjallë të Prishtinës, ku fqinjët serbë ishin pjesë përbërëse e përditshmërisë sonë. Pavarësisht se nuk ishim miq të ngushtë, ne ndamë shkollat, vendet e punës dhe aktivitetet kulturore që nxisnin një ndjenjë komuniteti dhe përkatësie. Përmes kësaj letre dëshiroj t'ju përcjell pritjet dhe aspiratat e mia për promovimin e kohezionit social midis komunitetit shqiptar dhe atij serb në mbarë Kosovën. Duke reflektuar për frymën bashkëpunuese të së kaluarës dhe për mundësitë e së tashmes, besoj se kultivimi i unitetit dhe respektit të ndërsjellë është thelbësor për të ardhmen tonë të përbashkët.

Për sa i përket komunitetit fetar, e vlerësoj thellë rolin që e luajnë udhëheqësit fetarë në promovimin e unitetit dhe të mirëkuptimit ndërmjet grupeve të ndryshme etnike dhe fetare. Në një shoqëri që shpesh herë është e ndarë sipas vijave etnike, unë fenë e shoh si një forcë bashkuese që mund të frymëzojë paqe dhe harmoni. Në dërgimin e mesazheve të tolerancës dhe të paqes, duke i nxitur ndjekësit tuaj për t'i përqaftuar këto vlera si thelbësore për mirëqenien tonë kolektive, roli juaj është vendimtar.

Unë përkrah nismat bashkëpunuese humanitare dhe programet e shtrirjes në komunitet që mund t'i kapërcejnë hendeqet dhe ta kultivojnë solidaritetin midis komunitet shqiptar dhe atij serb. Duke u angazhuar në përpjekje të tilla të përbashkëta, ne mund të kultivojmë marrëdhënie të bazuara në dashamirësinë dhe vlerësimin reciprok.

Le të përpiqemi së bashku për ta krijuar një shoqëri ku çdo individ, pavarësisht nga etnia apo prejardhja e vet, do të ndihet i vlerësuar dhe i respektuar. Unë besoj në aftësinë tonë kolektive për të ndërtuar një komunitet harmonik për brezat që do të vijnë.

Me respekt,

Leonora Kryeziu

Jovana Radosavljević, Drejtoreshë Ekzekutive
New Social Initiative
Mitrovicë e Veriut, Kosovë

I dashuri Kryepriift Arsić,

Shpresoj që kjo letër do t'ju gjejë mirë. Unë quhem Jovana Radosavljević, dhe jam një aktiviste serbe e Kosovës e shoqërisë civile nga Mitrovica e Veriut. Jam thellësisht e përkushtuar ndaj përpjekjeve për pajtimin midis serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës. Këtë jam duke shkruar si pjesë e Karvanit Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë, për t'i ndarë pritjet dhe dëshirat e mia për bashkëjetesën multietnike në Kosovë.

Kisha Ortodokse Serbe ka qenë gjithmonë gur-themel për komunitetin serb në Kosovë, duke ofruar udhëzime dhe mbështetje shpirtërore. Udhëheqja juaj në Kishën e Shën Nikollës ju vendos në një rol vendimtar për rritjen e harmonisë ndëretnike. Inkurajimi i dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet grupeve të ndryshme fetare dhe etnike mund ta rrisë ndjeshëm unitetin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë në komunitetet tona. Ju nxis që t'i mbështesni programet e komunitetit dhe projektet e shërbimeve të përbashkëta që bashkojnë njerëz të prejardhjeve të ndryshme. Predikimet dhe fjalimet tuaja publike duhet të vazhdojnë ta theksojnë rëndësinë e unitetit, të tolerancës dhe të respektimit të të gjithëve.

Duke shikuar përpara, unë parashoh një Kosovë ku bashkëjetesa multietnike dhe toleranca fetare, jo vetëm që janë të mundura, por janë edhe plotësisht të përvetësuara. Takimet e rregullta ndërfaqetare dhe nismat ndërkulturore mund ta nxisin dialogun dhe bashkëpunimin, duke ndihmuar shkatërrimin e pengesave dhe ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme.

Si përfundim, ju inkurajoj t'i vazhdoni përpjekjet tuaja për ndërtimin e një komuniteti paqësor dhe gjithëpërfshirës. Udhëheqja juaj mund të frymëzojë të tjerë për ta krijuar një të ardhme ku në Kosovë të gjithë do të ndjehen si në shtëpinë e vet, pavarësisht nga prejardhja e tyre etnike apo fetare.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Sinqerisht,

Jovana Radosavljević

Dr. Robert Muharremi
Fred C. Cuny Center for Peace and Conflict Studies
Rochester Institute of Technology in Kosovo
Prishtinë, Kosovë

I dashuri Kryepriфт, z. Staniša Arsić,

Qendra Fred C. Cuny për Studime të Paqes dhe të Konfliktëve në Institutin Rochester të Teknologjisë në Kosovë ofron një platformë akademike për studimin dhe mësimin e shkaqeve, të praktikave dhe të pasojave të luftës dhe dhunës politike, si dhe të metodave të menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktëve. Hulumtimi jonë ndihmon akademikët, qeveritë, praktikuesit dhe shoqërinë civile për ta kuptuar natyrën e konfliktit dhe për t'i formuluar politikat efektive të zgjidhjes. Qendra jonë është në krye të bashkimit të qendrave kërkimore dhe të organizatave të shoqërisë civile që përfaqësojnë komunitetet e ndryshme të Kosovës dhe nxisin një klimë të mirëkuptimit dhe të tolerancës së ndërsjellë.

Jam duke ju shkruar për ta shprehur mbështetjen e plotë, si timen, ashtu edhe të Qendrës sonë, për nismën e Karvanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë. Kosova është një shoqëri multietnike, demokratike dhe pluraliste, dhe besoj se respektimi i Kushtetutës së Kosovës, e cila i ruan këto vlera dhe orientimin euroatlantik të Kosovës, nuk është vetëm kritik, por është edhe vetë thelbi i asaj që Kosova përfaqëson.

Shpresoj se do ta shprehni mbështetjen tuaj të plotë për një Kosovë multietnike dhe për respektimin e plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të vlerave të saj thelbësore për ta siguruar një Kosovë të të gjitha komuniteteve, dhe për të gjitha komunitetet. Po ashtu shpresoj se do ta promovoni publikisht nevojën për integrim kuptimplotë të të gjitha komuniteteve, për dialog ndëretnik përmbajtësor, dhe për frymë tolerance dhe kompromisi në kuadër të Kushtetutës së Kosovës. Unë po ashtu shpresoj se do të qëndroni për një kulturë politike që promovon diversitetin, sundimin e ligjit, dhe respektimin e të drejtave të njeriut, dhe që pa kurrfarë kompromisi e çon përpara orientimin euroatlantik të Kosovës.

Shpresoj të shoh se do të përpiqemi së bashku për një shoqëri ku shqiptarët dhe serbët dhe të gjitha komunitetet e tjera do të jetojnë së bashku në harmoni dhe me mirëkuptim e respekt të ndërsjellë.

Jam i bindur se mund ta krijojmë një shoqëri paqësore dhe përfshirëse ku diversiteti në shtetin tonë multietnik do të lartësohet, dhe çdo individ do të ndihet i vlerësuar dhe i respektuar.

Ju falemnderit për përkushtimin tuaj për këtë kauzë fisnike.

Sinqerisht,

Dr. Robert Muharremi

Dušan Radaković, Drejtor Ekzekutiv
Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC)
Mitrovicë e Veriut, Kosovë

I dashuri Kryepriift,

Unë quhem Dušan Radaković dhe jam Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC – Advocacy Center for Democratic Culture). I lindur në vitin 1984 në Mitrovicë, unë që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë kam qenë thellësisht i përkushtuar për nxitjen e dialogut dhe të bashkëpunimin ndëretnik. Gjatë viteve kam marrë pjesë në nisma të shumta multietnike, duke punuar së bashku me organizata të ndryshme ndërkombëtare për të promovuar paqen dhe mirëkuptimin ndërmjet komuniteteve të ndryshme.

Me gradën Master të Drejtësisë dhe me një përvojë të gjerë në shoqërinë civile, përfshirë këtu edhe rolet në media dhe menaxhimin e projekteve, unë karrierën time ia kam kushtuar avokimit për vlerat demokratike dhe për të drejtat e njeriut. Qëllim i kësaj letre është t'i ndaj pritjet dhe dëshirat e mia personale lidhur me avancimin e bashkëjetesës multietnike në Kosovë, si pjesë e Karvanit Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë.

Udhëheqja juaj në komunitetin ortodoks serb është vendimtare për nxitjen e paqes dhe të bashkëjetesës. Shpresoj të shoh ngjarje bashkëpunuese që nxjerrin në pah vlerat e përbashkëta dhe trashëgiminë kulturore midis komunitetit serb dhe atij shqiptar. Në këtë drejtim, unë parashikoj një të ardhme ku bashkëjetesa multietnike në Kosovë do të jetë normë, me komunitetet që i lartësojnë dallimet etnike si pika të forta, dhe jo si burime të ndarjes.

Mendoj se synimet tona afatgjata duhet ta përfshijnë krijimin e programeve të qëndrueshme që promovojnë edukimin për diversitetin kulturor, mbështetjen e projekteve të përbashkëta të komunitetit dhe sigurimin e përfaqësimit të barabartë të të gjitha grupeve etnike në qeverisjen lokale.

Ju inkurajoj të merrni pjesë aktive në ndërtimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës duke mbështetur iniciativat ndëretnike, duke avokuar për politika që garantojnë mundësi të barabarta për të gjithë dhe duke nxitur dialogun e hapur dhe me respektim ndërmjet grupeve të ndryshme etnike.

E përfundoj këtë letër me një shënim shprese, duke shprehur dëshirën time për një të ardhme më të ndritur, ku përpjekjet tona kolektive do të çojnë në një shoqëri vërtet harmonike dhe multietnike në Kosovë. Unë besoj se me angazhimin tonë të përbashkët ne mund të arrijmë përparim të rëndësishëm në këtë kauzë fisnike.

Përsëritje të përzemërta,

Dušan Radaković

Ilir Deda,
Aktivist i Shoqërisë Civile
Prishtinë, Kosovë

I dashuri Kryepriift Arsić,

Për më shumë se dy dekada me radhë unë kam qenë i angazhuar dhe i përfshirë në role të ndryshme në çështjet kyçe për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor, përfshirë këtu edhe ruajtjen dhe përparimin e diversitetit në vendin tonë.

Qëllim i kësaj letre është t'i shikojë mundësitë për ta zgjeruar përfshirjen tuaj në promovimin e Prishtinës si një qytet i hapur për të gjithë njerëzit, që përfshin bashkëjetesën multietnike dhe multifetare në kryeqytetin tonë. Kjo është posaçërisht e rëndësishme tash kur qëndrimet populiste dhe përjashtuese janë duke fituar hapësirë.

Harmonia ndërjetare duhet të ruhet dhe të promovohet më tutje. Kisha Ortodokse Serbe ka rol në ruajtjen dhe promovimin e kësaj vlere. Unë besoj se janë disa veprime afatshkurtra dhe disa afatgjata që mund të ndërmerren nga ju dhe që ato më pas të shndërrohen në praktika. Disa prej tyre burojnë nga praktikatat e kaluara.

Në të kaluarën ishte një praktikë ku udhëheqësit fetarë publikisht ia uronin njëri-tjetrit festat më të rëndësishme fetare. Rivendosja e kësaj praktike, edhe pse simbolike, do të ishte hap fillestar drejt avancimit të respektimit ndërjetar në vendin tonë. Kjo do ta nënkuptonte respektimin e festave më të rëndësishme fetare për anëtarët e komuniteteve islame, katolike dhe protestante.

Dialogu dhe mirëkuptimi më i madh ndërjetar janë forma moderne që synojnë ta avancojë bashkëjetesën dhe harmoninë ndërjetare. Edhe pse jetojmë në një kohë kur harmonia nuk vlerësohet, besoj se është koha e duhur për ta konsideruar vendosjen e dialogut ndërjetar në nivel komunal lokal dhe për fillimin e krijimit të kulturës së paqes. Ky forum do ta avancojë mirëkuptimin e ndërsjellë ndërmjet liderëve fetarë lokalë, duke përfshirë këtu edhe mirëkuptimin me autoritetet komunale lokale. Ky po ashtu do të shërbente edhe si një forum për t'i diskutuar dhe adresuar nevojat përkatëse të çdonjërit nga komunitetet fetare.

Së fundi, vizita te Kryetari i Komunës së Prishtinës do ta kishte një ndikim të rëndësishëm në avancimin e bashkëjetesës paqësore ndëretnike në komunën e Prishtinës. Dialogu i përhershëm me Zyrën e Kryetarit mund të hetohet si një nga forumet për t'i diskutuar nevojat e Kishës Ortodokse Serbe në komunën e Prishtinës, si dhe të popullatës serbe që jeton në këtë komunë. Në nivelin lokal, ne që të gjithë e kemi një rol për ta filluar krijimin e kulturës së paqes.

E kam një besim të fuqishëm se lidershipi juaj është kritik në këtë pikë të zhvillimit të komunës sonë, dhe shpreh shpresën time se do t'i merrni parasysh veprimet e propozuara.

Me përshëndetjet më të sinqerta,

Ilir Deda

**Senad Sabović, Këshilltar i Lartë
Instituti Evropian për Paqe
Bruksel – Prishtinë**

I nderuari Kryepriift Arsić,

Unë quhem Senad Sabović dhe jam duke ju shkruar si përkrahës i projektit të quajtur Karvani Shumëetnik për Paqe dhe Bashkëjetesë. Unë punoj si Këshilltar i Lartë në Institutin Evropian të Paqes, me përqendrim kryesor në mbështetjen e Dialogut të ndihmuar nga BE-ja dhe të procesit të normalizimit në përgjithësi. Organizata ime është pjesë e një koalicioni të shoqërisë civile që quhet Alternativa Qytetare e Kosovës (KCA), e cila përpiket ta japë një kontribut konkret në këtë fushë.

Kjo letër ka për qëllim t'i shprehë pritjet që i kam nga Ju sa i përket multietnicitetit dhe bashkëjetesës. Parimet e shoqërisë multietnike janë të rrënjosura thellë në sistemin ligjor dhe kushtetues të Kosovës. Ato po ashtu vazhdojnë të jenë pritjet kryesore të bashkësisë ndërkombëtare dhe janë mekanizmi parësor për mirëqenien e komuniteteve joshumicë në Kosovë, dhe në veçanti të komunitetit serb. Si të tilla, parimet e multietnicitetit, të mirëkuptimit dhe të bashkëjetesës paqësore duhet të pasqyrohen në tërësi edhe në jetën fetare të Kosovës. Në këtë drejtim është bërë punë shumë e madhe, por ajo duhet të forcohet dhe të zgjerohet edhe më tutje, dhe posaçërisht në këtë kohë të tendosjes së shtuar dhe të normalizimit të ngecur. Gjatë viteve, me një vlerësim të lartë e kam vërejtur pjesëmarrjen aktive të Kishës suaj në aktivitete të ndryshme të dialogut ndërfaqetare dhe në forma të tjera të ndryshme të kontribuimit për bashkëjetesën paqësore.

Unë dhe kolegët e projektit dëshirojmë t'ju inkurajojmë që t'i zgjeroni këto nisma, si dhe t'i ofrojmë disa sugjerime në këtë drejtim. E kuptoj shumë mirë pozitën e veçantë të Kishës Ortodokse Serbe (KOS) në Kosovë dhe ndjeshmëritë që vijnë me këtë pozitë. Megjithatë, kontributi juaj aktiv në forcimin e ndjenjës së multietnicitetit dhe të tolerancës – siç ka ndodhur shpesh herë – do të krijonte një vlerë të shtuar domethënëse. Në këtë mënyrë, qoftë për t'iu përgjigjur nismave pozitive të jashtme ose për t'i nisur vetë tuajat, duhet të përdoret çdo mundësi që multietniciteti të theksohet si vlerë. Kjo mund të përfshijë njoftime të përbashkëta për shtyp, përmbytje të mediave sociale, ose vizita të përbashkëta me udhëheqës të ndryshëm fetarë ose institucionalë në qendrat dhe vendet komunitare. Një mënyrë tjetër efektive për të dhënë kontribut do të ishte theksimi, sipas rasteve, i mesazheve të tolerancës dhe të respektimit të Besimit Tuaj në angazhimet tuaja me besimtarët. Më në veçanti, unë u kam sugjeruar edhe përfaqësuesve të tjerë fetarë me seli në Prishtinë krijimin e një këshilli ndërfaqetare nga krerët e feve të ndryshme në Kosovë, i cili do t'i koordinonte dhe këshillonte institucionet e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë lidhur me mbrojtjen dhe rehabilitimin e objekteve të cenueshme fetare në mbarë Kosovën. Ju dhe Kisha juaj mund të dëshironi po ashtu që ta shqyrtoni mundësinë që ta nisni këtë ndërmarrje. Kjo jo vetëm që do të përmirësonte mirëqenien fizike të këtyre vendeve, por po ashtu edhe do të rikonfirmonte vazhdimisht mesazhin e tolerancës dhe të respektimit, që është aq integral për Besimin.

Mund të jeni të sigurt, i nderuar Kryepriift, se kolegët e mi nga Instituti Evropian i Paqes, nga ky projekt, si dhe nga koalicioni i përmendur i KCA-së, do të ishin më se të gatshëm për t'ju ofruar mbështetje konkrete Juve dhe udhëheqësve tuaj fetarë në zbatimin e sugjerimeve të parashikuara në këtë letër.

Me respekt dhe vlerësim të lartë,

Senad Sabović

**Ramadan Ilazi, Udhëheqës i Hulumtimeve
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Kryepriift, Staniša Arsić,

Unë quhem Ramadan Ilazi, dhe për momentin jam udhëheqës i hulumtimeve në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Me një përvojë në studimet për paqe dhe konflikte, me diplomën Master nga Universiteti St. Andrews, dhe me doktoraturë nga Universiteti i Qytetit të Dublinit (DCU), unë karrierën tima ia kam kushtuar promovimit të Kosovës si një shoqëri demokratike dhe e larmishme. Rolet e mia kanë përfshirë të qenit aktivist, udhëheqës organizatash, si dhe shërbimin si Zëvendësministër për Integritet Evropian.

Kushtetuta e Kosovës fillon me vizionin e ndërtimit të një të ardhmeje si një vend i lirë, demokratik dhe paqedashës i të gjithë qytetarëve të vet. Ky vizion është thelbësor, dhe përmbushja e tij është përgjegjësi jona kolektive. Në qendër të këtij vizioni është ideja që Kosova është shtëpi e të gjithë qytetarëve të vet, të cilët duhet ta kenë ndjenjën e përkatësisë dhe të krenarisë.

Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë e ka një rol të thellë në promovimin e paqes, tolerancës dhe të bashkëpunimit ndëretnik. Udhëheqja juaj mund të frymëzojë përpjekje që e theksojnë respektin e ndërsjellë.

Si Famullitar i Prishtinës, ndikimi juaj në promovimin e harmonisë dhe të mirëkuptimit ndëretnik është vendimtar. Ju inkurajoj të avokoni për paqe dhe respektim të ndërsjellë përmes nismave të Kishës dhe angazhimit të komunitetit. Unë propozoj takime të rregullta ndërmjet të gjithë udhëheqësve fetarë në Kosovë për ta nxitur dialogun dhe bashkëpunimin. Këto takime mund të rezultojnë në deklarata dhe nisma të përbashkëta që e nxisin unitetin dhe mirëkuptimin. Ju ftoj të flisni më aktivisht dhe publikisht përmes deklaratave dhe opinioneve që apelojnë për respekt të ndërsjellë, dhe bashkëpunim e mirëkuptim midis bashkësive etnike.

Më konkretisht, sugjeroj që Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë t'i iniciojë disa aktivitete për ndërtimin e komunitetit për promovimin e tolerancës fetare dhe ndëretnike. Një ide është të organizohet një "Ditë e Miqësisë Ndërfetare," ku anëtarët e komuniteteve të ndryshme fetare mund të mblidhen, të ndajnë ushqimet, dhe të marrin pjesë në diskutime e aktivitete kulturore. Një iniciativë tjetër me ndikim mund të jetë krijimi i një vargu të ditëve të "Shtëpisë së Hapur" në kishë, ku njerëz të të gjitha prejardhjeve do të ftoheshin për të mësuar për besimin ortodoks serb, traditat e tij dhe për kontributin e tij në trashëgiminë kulturore të Kosovës. Ju thërras që për vizita në Manastirin e Deçanit, Manastirin Patriarkal të Pejës, dhe Manastirin e Graçanicës, të ftoni hapur dhe zyrtarisht edhe liderët politikë, opinionistët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Por po ashtu ftoni edhe në vizita për ta festuar trashëgiminë kulturore të UNESCO-s, të tillë si vendi i trashëgimisë kulturore të UNESCO-s, Zoja Jonë e Ljevishit në Prizren.

Jam i bindur se këto nisma, së bashku me udhëheqësinë tuaj të përkushtuar, do të kontribuojnë shumë në rritjen e një shoqërie më përfshirëse dhe më harmonike në Kosovë.

Ju falemnderit,

Ramadan Ilazi

Dimitrije Obrenović,
Koordinator i Projekteve,
NGO Aktiv
Mitrovica e Veriut, Kosovë

I dashuri Kryepriift Arsić,

Shpresoj që kjo letër do t'ju gjejë mirë. Quhem Dimitrije Obrenović, dhe jam një aktivist serb i Kosovës i shoqërisë civile nga Mitrovica e Veriut. Jam thellësisht i përkushtuar ndaj përpjekjeve për pajtim midis serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës. Këtë letër po e shkruaj si pjesë e Karvanit Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë, për t'i ndarë pritjet dhe dëshirat e mia për bashkëjetesën multietnike në Kosovë.

Kisha Ortodokse Serbe ka qenë gjithmonë shtyllë për komunitetin serb në Kosovë, duke ofruar udhërrëfim dhe mbështetje shpirtërore. Si udhëheqës i Kishës së Shën Nikollës, ju e keni një mundësi unike për ta promovuar harmoninë ndëretnike. Duke inkurajuar dialogun dhe bashkëpunimin midis grupeve të ndryshme fetare dhe etnike, ju mund ta përmirësoni ndjeshëm unitetin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë në komunitetet tona. Ju nxis t'i mbështesni programet e komunitetit dhe projektet e shërbimeve të përbashkëta që bashkojnë njerëz nga të gjitha fushat e jetës. Predikimet dhe fjalimet tuaja publike duhet të vazhdojnë ta theksojnë rëndësinë e unitetit, tolerancës dhe të respektit për të gjithë.

Unë e përfytyroj një Kosovë ku jeta multietnike dhe toleranca fetare nuk janë thjesht të mundshme, por edhe lartësohen. Takimet e rregullta dhe ngjarjet kulturore mund ta ndezin dialogun dhe bashkëpunimin, duke rrënuar pengesat dhe duke ndërtuar marrëdhënie ta qëndrueshme.

Në përfundim, vazhdoni të përpiqeni për një komunitet paqësor dhe përfshirës. Udhëheqja juaj mund t'i frymëzojë të tjerët për ta krijuar një të ardhme ku në Kosovë të gjithë, pavarësisht nga prejardhja e tyre, do të ndihen si në shtëpinë e vet.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Sinqerisht,

Dimitrije Obrenović

**Mentor Agani, Hulumtues i Lartë
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave
Prishtinë, Kosovë**

I nderuari Kryepift Arsić

Unë jam Mentor Agani, Hulumtues i Lartë në KIPRED, Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave, si dhe Ligjërues në Kolegjin Dardania në Prishtinë. Po ashtu kam dhënë mësim edhe në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës (në periudhën 2003-2016). Këtë letër jam duke e shkruar për t'i shprehur disa nga pritjet dhe dëshirat e mia lidhur me bashkëjetesën ndëretnike në Kosovë, dhe për t'i përmendur disa aktivitete që mund të ndërmerren në këtë drejtim.

Ndërkohë që jam i vetëdijshëm se Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë dhe Ju po kaloni nëpër vështirësi të mëdha, jam i bindur se si Ju, ashtu edhe institucionet e Kishës suaj, mund ta jepni një kontribut të rëndësishëm drejt normalizimit të marrëdhënieve etnike në Kosovë. Ka shumë aspekte të predikimeve fetare që janë në përputhje të plotë me qëllimin politik dhe social për përmirësimin e marrëdhënieve etnike në Kosovë, dhe posaçërisht të atyre midis komuniteteve shqiptare dhe serbe. Prandaj, pres që në mesin e institucioneve të Kishës Ortodokse Serbe të ketë përpjekje për të vënë një përqendrim të veçantë në pikërisht këto aspekte në predikimin e priftërinjve ortodoksë serbë.

Për shembull, paraqitja dhe trajtimi i qenieve njerëzore, pavarësisht prejardhjes së tyre etnike, si krijimet më të larta të Zotit, dhe, rrjedhimisht, edhe si vlerat më të larta shoqërore, me siguri se është një aspekt i tillë që mund të theksohet në predikimin e priftërinjve ortodoksë serbë. Unë besoj se shumë besimtarë të prirur drejt nacionalizmit do t'i ndryshonin qëndrimet e tyre nëse priftërinjtë e tyre do të këmbëngulin në predikimet e veta se urrejtja kundër anëtarëve të etnive të tjera është urrejtje kundër krijesave të Zotit.

Një aspekt tjetër i tillë është demonstrimi i përkushtimit ndaj paqes, tolerancës dhe bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Në të vërtetë, promovimi i bashkëjetesës paqësore dhe tolerante të bashkësive të ndryshme shoqërore, jo vetëm si synim politik i ndonjë politike demokratike, por, mbi të gjithat, si vlerë dhe virtyt fetar, sigurisht që do të ishte një kontribut i rëndësishëm në përmirësimin e marrëdhënieve etnike në Kosovë. Priftërinjtë ortodoksë serbë duhet të jenë përkrahës të zëshëm të tolerancës dhe bashkëjetesës, duke dënuar publikisht dhunën dhe diskriminimin, dhe duke promovuar bashkëjetesën paqësore. Të gjithë priftërinjtë, të çfarëdo feje qofshin, ortodoksë serbë, katolikë shqiptarë, si dhe imamët, duhet të udhëheqin me shembullin e tyre, duke treguar me veprimet dhe fjalët e tyre se mund të kontribuojnë në harmoninë multietnike. Një dëshirë tjetër imja është që komunitetet fetare kosovare të jenë në marrëdhënie më të mira të mundshme dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. Kisha Ortodokse Serbe mund të kontribuojë për këtë duke treguar gatishmëri për bashkëpunim dhe ndjeshmëri ndaj praktikave kulturore dhe fetare të komuniteteve të tjera.

Përsëri, jam i vetëdijshëm për vështirësitë me të cilat po përballeni, dhe për atë se këto imponojnë kufizime të jashtëzakonshme për përmbushjen e këtyre pritjeve dhe dëshirave të mia. Mirëpo, unë jam po ashtu i vetëdijshëm se me këmbëngulje dhe qëndrueshmëri mund të kemi sukses në përmirësimin e marrëdhënieve etnike në Kosovë dhe në shndërrimin e Kosovës në një vend më të mirë në të ardhmen.

Ju falemnderit, dhe të gjitha të mirat,

Mentor Agani

Zoran Savič, Koordinator i Projekteve
NGO AKTIV
Mitrovicë e Veriut, Kosovë

I dashuri Kryeprift Arsić,

Quhem Zoran Savić dhe jam Koordinator i Projekteve në organizatën joqeveritare Aktiv të Mitrovicës së Veriut. Edhe pse jam lindur në Pulë të Kroacisë, unë në të vërtetë kam jetuar në Mitrovicë për 30 vite dhe jam i përfshirë aktivisht në jetën shoqërore të Kosovës, si përmes punës, ashtu edhe përmes jetës kulturore, duke pasur parasysh se jam edhe muzikant dhe kam marrë pjesë në projekte të shumta ndëretnike me muzikantë të kombësisë shqiptare. Në të njëjtën kohë, për shumë vite kam punuar si gazetar në portalin Kosova Sever – KoSSev, dhe përmes kësaj jam bërë edhe më i afërt me gjendjen politike, të sigurisë, dhe atë fetare në Kosovë.

Kisha Ortodokse Serbe ka qenë gjithmonë një gur-themeli për komunitetin serb në Kosovë, duke ofruar udhërrëfim dhe mbështetje shpirtërore. Udhëheqja juaj e Kishës së Shën Nikollës ju vendos në një rol vendimtar për nxitjen e harmonisë ndëretnike. Inkurajimi i dialogut dhe bashkëpunimit midis grupeve të ndryshme fetare dhe etnike mund ta rrisë ndjeshëm unitetin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë në komunitetet tona. Ju nxis që t'i mbështesni programet e komunitetit dhe projektet e shërbimeve të përbashkëta që bashkojnë njerëz me prejardhje të ndryshme. Predikimet dhe fjalimet tuaja publike duhet të vazhdojnë ta theksojnë rëndësinë e unitetit, tolerancës dhe respektit për të gjithë.

Në këtë frymë, shpresoj për një të ardhme ku bashkëjetesa multietnike fetare në Kosovë do të shndërrohen në normë. Unë në të ardhmen shoh komunitete ku dallimet fetare merren si anë të forta, jo si burime ndarjeje. Për këtë qëllim, ju mund të përqendroheshi në krijimin e programeve të qëndrueshme që edukojnë për diversitetin dhe tolerancën fetare, që mbështesin projektet e përbashkëta të komunitetit dhe sigurojnë përfaqësim të barabartë të të gjitha grupeve fetare në qeverisjen vendore.

Duke shikuar përpara, unë e shoh një Kosovë ku bashkëjetesa multietnike dhe toleranca fetare janë të përvetësuara. Takimet e rregullta ndërfitare dhe nismat ndërkulturore mund të nxisin dialog dhe bashkëpunim.

Këtë letër e përfundoj me një vërejtje shpresëdhënëse, duke parashikuar një të ardhme ku përpjekjet tona të bashkuara do ta kultivojnë një shoqëri vërtet harmonike dhe multietnike në Kosovë. Jam i sigurtë se me përkushtimin tonë të përbashkët, ne mund ta arrijmë një përparim të jashtëzakonshëm drejt këtij qëllimi të çmuar.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Zoran Savić



Letrat e Dëshirave dhe Pritjeve

Leonora Kryeziu, Jovana Radosavljević, Robert Muharremi, Dušan Radaković, Ilir Deda, Senad Sabović, Ramadan Ilazi, Dimitrije Obrenović, Mentor Agani dhe Zoran Savić

Pastor Artur Krasniqi
Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës

Korrik 2024

**Leonora Kryeziu, Drejtoreshë Ekzekutive
Instituti i Prishtinës për Studime Politike
Prishtinë, Kosovë**

I nderuar Pastor Krasniqi,

Unë jam Leonora Kryeziu, banore e Prishtinës, e lindur në vitin 1971. Duke qenë se i takoj një gjenerate që fëmijërinë dhe rininë e kam kaluar në ish-Jugosllavi, mbaj mend mirë se si dukej bashkëjetesa multi-etnike në Prishtinë. Ajo kishte ngjyrimet të një bashkëjetese ndër-etnike deri diku të qetë.

Me këtë letër, dua të ndaj me ju pritjet dhe dëshirat e mia personale në lidhje me promovimin e kohezionit social ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij serb në kryeqytet, dhe jo vetëm duke u përqendruar në të kaluarën, por edhe në mundësitë që na ofron e tashmja dhe e ardhmja të cilën duhet ta ndërtojmë së bashku.

Në lidhje me komunitetin protestant, vlerësoj thellësisht rolin dhe veprimet tuaj në promovimin e bashkëjetesës dhe në kuptimit e ndërsjellë midis grupeve të ndryshme etnike dhe fetare. Në shoqëri të ndara etnikisht, besoj se liderët fetarë kanë rol të rëndësishëm për t'i bashkuar njerëzit dhe për t'i frymëzuar ata drejt paqes dhe harmonisë.

Roli juaj është shumë i rëndësishëm në transmetimin e mesazheve të tolerancës dhe paqes, duke inkurajuar besimtarët tuaj t'i pranojnë këto vlera si të rëndësishme për bashkëjetesën tonë. Nismat e përbashkëta humanitare dhe programet e shërbimit në komunitet mund të ndihmojnë në tejkalimin e ndarjeve dhe në kultivimin e solidaritetit mes komuniteteve shqiptare dhe serbe. Duke u angazhuar në aktivitete të tilla të përbashkëta, ne mund të ndërtojmë marrëdhënie të bazuara në dashamirësi dhe në vlerësim reciprok.

Duke ju falenderuar për vëmendjen, shpreh besimin në vullnetin tonë të përbashkët për ta ndërtuar një shoqëri harmonike me bashkëjetesë etnike dhe fetare për brezat e ardhshëm.

Me respekt,

Leonora Kryeziu

Jovana Radosavljević, Drejtoreshë Ekzekutive
New Social Initiative
Mitrovicë e Veriut, Kosovë

I dashuri Pastor Krasniqi,

Shpresoj që kjo letër do t'ju gjejë mirë. Quhem Jovana Radosavljević, dhe jam një aktiviste serbe e Kosovës e shoqërisë civile nga Mitrovica e Veriut, e përqendruar në përpjekjet për pajtimin midis serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës. Jam duke ju shkruar si pjesë e Karvanit Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë për të ndarë pritjet dhe dëshirat e mia për bashkëjetesën multietnike në Kosovë.

Udhëheqja juaj në Kishën Protestante Ungjillore të Kosovës juve ju vendos në një pozitë unike për ta promovuar harmoninë ndëretnike. Inkurajimi i dialogut dhe bashkëpunimit midis grupeve të ndryshme fetare dhe etnike mund ta rrisë ndjeshëm unitetin në komunitetet tona. Ju nxis që t'i mbështesni programet e komunitetit dhe projektet e shërbimeve të përbashkëta që bashkojnë njerëz me prejardhje të ndryshme. Predikimet dhe fjalimet tuaja publike mund ta theksojnë rëndësinë e unitetit, të tolerancës dhe të respektimit për të gjithë.

Duke shikuar përpara, unë e shoh një Kosovë ku bashkëjetesa multietnike dhe toleranca janë realitet. Takimet e rregullta ndërfitare dhe nismat ndërkulturore mund ta nxisin dialogun dhe bashkëpunimin.

Në përfundim, ju inkurajoj t'i vazhdoni përpjekjet tuaja për ndërtimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës. Udhëheqja juaj mund t'i frymëzojë të tjerët për ta krijuar një të ardhme ku në Kosovë të gjithë do të ndihen si në shtëpinë e vet.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Sinqerisht,

Jovana Radosavljević

Dr. Robert Muharremi
Fred C. Cuny Center for Peace and Conflict Studies
Rochester Institute of Technology in Kosovo
Prishtinë, Kosovë

I dashuri Pastor Artur Krasniqi

Jam duke ju shkruar sot për ta shprehur vlerësimin tim për përkushtimin tuaj për promovimin e një Kosove multi-etnike dhe fetarisht tolerante. Përndryshe, Qendra Fred C. Cuny për Studime të Paqes dhe të Konfliktëve në Institutin Rochester të Teknologjisë në Kosovë ofron një platformë akademike për studimin dhe mësimin e shkaqeve, të praktikave dhe të pasojave të luftës dhe dhunës politike, si dhe të metodave të menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktëve. Hulumtimi jonë ndihmon akademikët, qeveritë, praktikuesit dhe shoqërinë civile për ta kuptuar natyrën e konfliktit dhe për t'i formuluar politikat efektive të zgjidhjes. Qendra jonë është në krye të bashkimit të qendrave kërkimore dhe të organizatave të shoqërisë civile që përfaqësojnë komunitetet e ndryshme të Kosovës dhe nxisin një klimë të mirëkuptimit dhe të tolerancës së ndërsjellë.

Jam duke ju shkruar për ta shprehur mbështetjen e plotë, si timen, ashtu edhe të Qendrës sonë, për nismën e Karvanit Multi-Etnik për Paqe dhe Bashkëjetesë. Kosova është një shoqëri multi-etnike, demokratike dhe pluraliste, dhe besoj se respektimi i Kushtetutës së saj, e cila i ruan këto vlera dhe orientimin euroatlantik të Kosovës, nuk është vetëm kritik, por është edhe vetë thelbi i asaj që Kosova përfaqëson.

Komuniteti Protestant luan një rol vendimtar në nxitjen e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit midis të gjitha grupeve. Drejtimi juaj është instrumental për të na udhëhequr drejt një të ardhmeje më përfshirëse. Shpresoj të shoh më shumë ngjarje ku protestantët bashkëpunojnë me komunitetet e tjera fetare në projekte nga të cilat përfitojnë të gjitha komunitetet në Kosovë. Kjo do të forcojë një ndjenjë të qëllimit të përbashkët dhe do t'i shkatërrojë pengesat. Do të doja po ashtu ta shihja komunitetin protestant duke organizuar diskutime të rregullta të hapura për të gjitha besimet dhe komunitetet etnike, ku anëtarët do të mund të mësojnë për besimet dhe traditat e njëri-tjetrit. Kjo nxit mirëkuptimin dhe respektimin.

Shpresoj të shoh se do të përqipemi së bashku për një shoqëri ku shqiptarët dhe serbët dhe të gjitha komunitetet e tjera do të jetojnë së bashku në harmoni me mirëkuptim dhe respektim të ndërsjellë. Udhëheqësia juaj e vazhdueshme do të jetë e dobishme në ndërtimin e një Kosove më të fortë dhe më përfshirëse për të gjithë.

Jam i bindur se mund ta krijojmë një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse ku diversiteti në shtetin tonë multi-etnik lartësohet, dhe ku çdo individ ndihet i vlerësuar dhe i respektuar.

Ju falemnderit për përkushtimin tuaj për këtë kauzë fisnike.

Sinqerisht,

Dr. Robert Muharremi

Dušan Radaković, Drejtor Ekzekutiv
Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC)
Mitrovicë e Veriut, Kosovë

I dashuri Pastor, Artur Krasniqi,

Unë quhem Dušan Radaković, dhe jam Drejtor Ekzekutiv i Qendrës Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC - Advocacy Center for Democratic Culture). I lindur në vitin 1984 në Mitrovicë, unë kam qenë thellësisht i përkushtuar për nxitjen e dialogut dhe bashkëpunimit ndëretnik që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë. Gjatë viteve kam marrë pjesë në nisma të shumta multietnike, duke punuar së bashku me organizata të ndryshme ndërkombëtare për ta promovuar paqen dhe mirëkuptimin ndërmjet komuniteteve të ndryshme.

Me Gradën Master në Drejtësi, dhe me një përvojë të madhe në shoqërinë civile, përfshirë rolet në media dhe në menaxhimin e projekteve, unë kam kushtuar përkrahjes së vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut. Qëllim i kësaj letre times është t'i ndajë pritjet dhe dëshirat e mia personale lidhur me përparimin e bashkëjetesës multietnike në Kosovë, si pjesë e Karvanit Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë.

Programet e komunikimit të kishës suaj mund ta luajnë një rol të rëndësishëm në kapërcimin e ndarjeve etnike. Unë pres mbështetjen tuaj në krijimin e iniciativave që të rinjtë me prejardhje të ndryshme etnike i bashkojnë për aktivitete të përbashkëta.

Në kuadër të kësaj, dëshira ime është ta shoh një të ardhme ku bashkëjetesa multietnike në Kosovë është normë. Unë i përfytyroj komunitetet ku dallimet etnike lartësohen si anë të forta, jo si burime ndarjeje. Në këtë drejtim, synimet afatgjata mund ta përfshijnë krijimin e programeve të qëndrueshme që promovojnë edukimin mbi diversitetin kulturor, mbështetjen e projekteve të përbashkëta të komunitetit dhe sigurimin e përfaqësimit të barabartë të të gjitha grupeve etnike në qeverisjen komunale.

Prandaj, ju bëj thirrje të angazhoheni aktivisht në ndërtimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës duke mbështetur nismat ndëretnike, duke promovuar politika që sigurojnë mundësi të barabarta për të gjithë, dhe duke inkurajuar dialog të hapur me respektim ndërmjet grupeve të ndryshme etnike.

Këtë letër e përfundoj me një shënim pozitiv, duke shprehur shpresën time për një të ardhme më të ndritur ku përpjekjet tona kolektive do të çojnë në një shoqëri vërtet harmonike dhe multietnike në Kosovë. Unë kam besim se, me angazhimin tonë të përbashkët, ne mund të bëjmë hapa të rëndësishëm drejt kësaj kauze fisnike.

Përsëritet të përzemërta,

Dušan Radaković

Ilir Deda,
Aktivisti i Shoqërisë Civile
Prishtinë, Kosovë

I dashur Pastor Krasniqi,

Për më shumë se dy dekada me radhë, unë kam qenë i përfshirë dhe i angazhuar në role të ndryshme në çështjet kyçe për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor, përfshirë këtu edhe ruajtjen dhe përparimin e diversitetit në vendin tonë.

Qëllim i kësaj letre është t'i shikojë mundësitë për ta zgjeruar përfshirjen tuaj në promovimin e Prishtinës si një qytet të hapur për të gjithë njerëzit, që përfshin bashkëjetesën multietnike dhe multifetare në kryeqytetin tonë. Kjo është posaçërisht e rëndësishme në këtë kohë kur qëndrimet populiste dhe përjashtuese janë duke fituar hapësirë.

Harmonia ndërjetare ka qenë ndër vlerat thelbësore të kombit tonë. dhe Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës ka rol për ruajtjen dhe promovimin e kësaj vlere. Unë besoj se janë disa veprime afatshkurtra dhe disa afatgjata që ju mund t'i ndërmerrni dhe t'i shndërroni në praktika. Disa prej tyre burojnë nga praktikatat e mëparshme.

Në të kaluarën, ka ekzistuar një praktikë ku udhëheqësit fetarë njëri-tjetrit ia uronin publikisht festat më të rëndësishme fetare. Rivendosja e kësaj praktike, edhe pse simbolike, do të ishte një hap fillestar drejt avancimit të respektimit ndërjetar në vendin tonë. Kjo do ta nënkuptonte respektimin e festave më të rëndësishme fetare për pjesëtarët e komuniteteve Islame, Katolike dhe Ortodokse.

Dialogu ndërjetar dhe mirëkuptimi më i madh është një formë moderne që synon avancimin e bashkëjetesës dhe të harmonisë ndërjetare. Edhe pse jetojmë në një kohë kur harmonia nuk është duke u vlerësuar, unë besoj se Kosova, duke pasur parasysh historinë e saj unike, mund ta vendosë një dialog ndërjetar në nivelin lokal komunal, për ta filluar krijimin e kulturës së paqes. Ky forum do ta çonte përpara mirëkuptimin e ndërsjellë midis udhëheqësve fetarë lokalë, duke përfshirë këtu edhe mirëkuptimin me autoritetet komunale lokale. Ai po ashtu do të shërbente edhe si një forum për t'i diskutuar dhe adresuar nevojat përkatëse të çdonjërit nga komunitetet fetare.

Së fundi, vizita te krerët fetarë ortodoksë lokalë do ta kishte një ndikim domethënës në avancimin e bashkëjetesës paqësore ndëretnike në vendin tonë. Kosova do të jetë e suksesshme vetëm nëse e ruan karakterin e saj multietnik dhe Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës e ka një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe avancimin e këtij karakteri të shtetit tonë.

Unë besoj fuqishëm se udhëheqja juaj është kritike në këtë pikë të zhvillimit të vendit tonë dhe shpreh shpresën se do të merrni parasysh veprimet e propozuara.

Me përshëndetjet më të sinqerta,

Ilir Deda

**Senad Sabović, Këshilltar i Lartë
Instituti Evropian për Paqe
Bruksel – Prishtinë**

I nderuari Pastor Krasniqi,

Unë quhem Senad Sabović, dhe po Ju shkruaj si përkrahës i projektit të quajtur Karvani Multietnik për Paqe dhe Bashkëjetesë. Unë punoj si Këshilltar i Lartë në Institutin Evropian për Paqe, me përqendrimin kryesor në mbështetjen e Dialogut të ndihmuar nga BE-ja dhe të procesit të normalizimit në përgjithësi. Organizata ime është pjesë e një koalicioni të shoqërisë civile të quajtur Alternativa Qytetare e Kosovës (AKK), e cila përpiqet ta japë një kontribut konkret në këtë fushë.

Kjo letër synon t'i shprehë pritjet e mia nga ju sa i përket multietnicitetit dhe bashkëjetesës. Siç dimë, Republika e Kosovës përkufizohet si shtet multietnik i të gjithë qytetarëve dhe komuniteteve të saj. Këto parime janë të rrënjësura thellë në sistemin kushtetues dhe ligjor të Kosovës. Ato po ashtu vazhdojnë të jenë edhe pritja kryesore e partnerëve tanë perëndimorë dhe e sistemit organizativ të komunitetit euroatlantik, hyrjen në të cilin ne e aspirojmë. Si të tilla, parimet e multietnicitetit, mirëkuptimit dhe të bashkëjetesës paqësore duhet të pasqyrohen plotësisht në jetën fetare të vendit tonë. Në këtë drejtim është bërë punë e madhe, por ajo duhet të forcohet dhe të zgjerohet edhe më tutje, dhe posaçërisht në këtë kohë të shtimit të tendosjeve dhe të ngecjes së normalizimit. Me kalimin e viteve, me një vlerësim të lartë e kam vënë re qëndrimin që ju dhe grumbullimet tuaja i keni marrë lidhur me këtë.

Unë dhe kolegët e projektit dëshirojmë t'ju inkurajojmë për t'i zgjeruar këto nisma, si dhe t'i ofrojmë disa sugjerime lidhur me këtë. Përgjithësisht, shfrytëzimi i mundësive të ofruara për ta theksuar multietnicitetin si vlerë është jashtëzakonisht i dobishëm. Kjo mund të përfshijë njoftime të përbashkëta për shtyp, përmbajtje të mediave sociale ose vizita të përbashkëta me udhëheqës të ndryshëm fetarë ose institucionalë në qendra dhe vende të rëndësishme komunitare. Theksimi i mesazheve të Besimit Tuaj për tolerancën dhe respektimin, sipas rastit, në angazhimet e tuaja me besimtarët do të ishte po ashtu një mënyrë efektive për të dhënë kontribut.

Më konkretisht, Ju, së bashku me udhëheqësit e feve të tjera të tjera të Kosovës, mund ta ndërmerrni nismën për krijimin e një këshilli ndërfeetar, i cili do ta koordinonte dhe këshillonte shtetin dhe donatorët ndërkombëtarë për mbrojtjen dhe rehabilitimin e objekteve të cënueshme fetare në mbarë Kosovën. Kjo jo vetëm që do të përmirësonte mirëqenien fizike të këtyre vendeve, por po ashtu do të rikonfirmonte vazhdimisht mesazhin e tolerancës dhe të respektit, që është aq integral për besimin tuaj, si në Kosovë ashtu edhe anembanë botës.

Sipas mendimit tim, edhe pse të pamësuar me këtë, Kisha dhe Komuniteti juaj janë një urë-ndërtues ideal në mesin e komuniteteve të ndryshme fetare dhe etnike të Kosovës dhe çdo angazhim përbrenda çfarëdo qoftë forme të procesit të dialogut ndërfeetar në këtë drejtim është me shumë gjasë që ta japë një rezultat shumë të shquar.

I nderuari Pastor, mund të jini të sigurtë se kolegët e mi, nga Instituti Evropian i Paqes, nga ky projekt, si dhe nga koalicioni i përmendur i OAK-së, do të jemi më se të gatshëm për t'ju ofruar mbështetje konkrete, Juve dhe udhëheqësve të tjerë fetarë në zbatimin e sugjerimeve të parapara këtu.

Me respekt dhe vlerësim të lartë,

Senad Sabović

**Ramadan Ilazi, Udhëheqës i Hulumtimeve
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
Prishtinë, Kosovë**

I dashuri Pastor Artur Krasniqi,

Quhem Ramadan Ilazi, dhe aktualisht jam udhëheqës i hulumtimeve në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Me një prapavijë në studimet për paqe dhe konflikte, me Diplomë Master nga Universiteti St. Andrews, dhe Doktoraturë nga Universiteti i Qytetit të Dublinit (DCU), unë karrierën time ia kam kushtuar promovimit të Kosovës si një shoqëri demokratike dhe e shumëllojshme. Rolet e mia kanë përfshirë të qenit aktivist, udhëheqjen e organizatave, dhe shërbimin si Zëvendësministër për Integritet Evropian.

Kushtetuta e Kosovës fillon me vizionin e ndërtimit të një të ardhmeje si një vend i lirë, demokratik dhe paqedashës i të gjithë qytetarëve të saj. Ky vizion është thelbësor, dhe realizimi i tij është përgjegjësi jona kolektive. Në qendër të këtij vizioni është ideja që Kosova është shtëpia e të gjithë qytetarëve të vet, të cilët duhet ta kenë ndjenjën e përkatësisë dhe të krenarisë.

Kisha Protestante Ungjillore e ka një rol të rëndësishëm për ta luajtur në promovimin e paqes, tolerancës dhe të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit ndëretnik. Si Udhëheqës i Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës, ndikimi juaj për avokimin për paqen dhe respektimin e ndërsjellë përmes nismave të kishës dhe angazhimit të komunitetit është vendimtar. Organizimi i dialogjeve ndërfaqetare, i projekteve të përbashkëta të shërbimit në komunitet dhe i ngjarjeve të shkëmbimit kulturor, mund të kontribuojnë ndjeshëm në ndërtimin e urave midis grupeve të ndryshme etnike dhe fetare.

Për më tepër, unë propozoj takime të rregullta të të gjithë udhëheqësve fetarë në Kosovë për ta nxitur dialogun dhe bashkëpunimin. Këto takime mund të rezultojnë në deklarata dhe nisma të përbashkëta që nxisin unitet dhe mirëkuptim. Përpjekjet e tilla mund të shërbejnë si një shembull i fuqishëm për të gjithë qytetarët, dhe këto mund ta forcojnë vizionin e një shoqërie paqësore dhe kohezive. Duke organizuar ngjarje që e lartësojnë diversitetin kulturor dhe etnik të Kosovës, ne mund ta krijojmë një model që frymëzon. Më konkretisht, do të doja t'ju inkurajoj të jeni më të zëshëm në publik me deklaratat dhe opinionet që thërrasin për tolerancë fetare dhe ndëretnike.

Unë po ashtu sugjeroj që Kisha Protestante Ungjillore e Kosovës të nisë një varg aktivitete për ndërtimin e komunitetit që promovojnë diversitetin etnik. Një ide është të organizohen pikniqe familjare ndëretnike dhe ngjarje sportive, ku familjet me prejardhje të ndryshme mund të mblidhen së bashku, t'i ndajnë ushqimet dhe të marrin pjesë në lojëra dhe aktivitete. Për më tepër, krijimi i një "Të diele të shkëmbimit kulturor" ku grupet e ndryshme etnike ftohen të ndajnë traditat, muzikën dhe historitë e tyre gjatë shërbesave të kishës, mund ta nxisë respektimin dhe mirëkuptimin reciprok.

Jam i bindur se këto nisma, të kombinuara me udhëheqësinë tuaj të përkushtuar, do të kontribuojnë në një masë të madhe nxitjes së një shoqërie më përfshirëse dhe më harmonike në Kosovë. Udhëheqja juaj, e drejtuar nga parimet e paqes dhe të shërbimit, mund ta frymëzojë një të ardhme ku diversiteti i Kosovës festohet si burim i forcës dhe unitetit.

Ju falemnderit,

Ramadan Ilazi

Dimitrije Obrenović,
Koordinator i Projekteve,
NGO Aktiv
Mitrovica e Veriut, Kosovë

I dashuri Pastor Krasniqi,

Quhem Dimitrije Obrenović dhe jam një aktivist për të drejtat e njeriut që jeton në Mitrovicën e Veriut. Unë përpiqem për të drejta të barabarta të njeriut dhe për nxitje të bashkëpunimit ndërfaqetare më të mirë, duke besuar fuqishëm se për një të ardhme më të mirë kërkohet bashkëpunim i mëtutjeshëm.

Udhëheqja juaj në kuadër të Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës juve ju vendos në një pozitë unike për ta promovuar harmoninë ndëretnike. Inkurajimi i dialogut dhe bashkëpunimit midis grupeve të ndryshme fetare dhe etnike mund ta rrisë ndjeshëm unitetin në komunitetet tona. Ju nxis që t'i mbështesni programet e komunitetit dhe projektet e shërbimeve të përbashkëta që bashkojnë njerëz me prejardhje të ndryshme. Predikimet dhe fjalimet tuaja publike mund ta theksojnë rëndësinë e unitetit, tolerancës dhe të respektimit të të gjithëve.

Duke shikuar përpara, unë e shoh një Kosovë ku bashkëjetesa multietnike është realitet. Takimet e rregullta ndërfaqetare dhe nismat ndërkulturore mund të nxisin dialog dhe bashkëpunim.

Si përfundim, ju inkurajoj t'i vazhdoni përpjekjet tuaja për ndërtimin e një komuniteti paqësor dhe përfshirës. Udhëheqja juaj mund t'i frymëzojë të tjerët për ta krijuar një të ardhme ku në Kosovë të gjithë do të ndjehen si në shtëpinë e vet.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Sinqerisht,

Dimitrije Obrenović

Mentor Agani, Hulumtues i Lartë
Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave
Prishtinë, Kosovë

I nderuari Pastor Artur Krasniqi,

Unë jam Mentor Agani, dhe jam Hulumtues i Lartë në KIPRED, Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave, si dhe ligjërues në Kolegjin Dardania në Prishtinë. Gjatë periudhës 2003-2016 kam qenë po ashtu edhe ligjërues në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Këtë letër po e shkruaj me synimin për t'i shprehur disa nga pritjet dhe dëshirat e mia lidhur me bashkëjetesën ndëretnike në Kosovë, dhe për t'i përmendur disa veprime që mund të ndërmerren lidhur me këtë.

Jam i vetëdijshtë se për komunitetin protestant të Kosovës, si një komunitet relativisht i ri dhe i vogël, mund të duket e vështirë që ta ketë ndonjë ndikim të konsiderueshëm në marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë, dhe posaçërisht duke pasur parasysh vështirësitë e mëdha me të cilat ky komunitet mund të jetë duke u përballur në fazat e tij të hershme në Kosovë. Megjithatë, jam plotësisht i bindur se ju, si dhe komuniteti protestant i Kosovës, mund ta jipni një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Mendoj se kjo duhet bërë duke e përqendruar – për aq sa kjo është e mundur – predikimin e pastorëve protestantë kosovarë në ato aspekte që kanë të bëjnë me qëllimin politik të Kosovës për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë. Për shembull, predikimi duhet të përqendrohet, sa më shpesh që të jetë e mundur, në paraqitjen e qenieve njerëzore, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike, si krijesat më të larta të Zotit, dhe rrjedhimisht, si vlerën më të lartë të çdo shoqërie. Ose, predikimi mund të përqendrohet edhe në lavdërimin fetar të marrëdhënieve të mira ndëretnike, duke artikuluar paqen, tolerancën, respektimin dhe bashkëpunimin ndërmjet grupimeve të ndryshme shoqërore si vlera fetare dhe virtyte morale.

Personalisht, kam jetuar për më shumë se tre vjet në SHBA dhe e di shumë mirë se demokracia dhe toleranca amerikane midis grupimeve të ndryshme shoqërore janë në një masë të madhe protestante në origjinën e tyre. Prandaj, mendoj se komuniteti protestant kosovar mund ta japë një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim. Edhe një çështje tjetër është ajo e gjendjes së Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë. Për shkak të rrethanave politike, kjo kishë është mjaft e izoluar dhe e shpërfillur nga institucionet fetare të feve të tjera kosovare. Mendoj se kjo situatë nuk është e pranueshme. Prandaj, institucionet fetare të të gjitha feve kosovare që kanë besimtarë shqiptarë duhet të organizohen bashkarisht për t'i vizituar së bashku institucionet fetare të Kishës Ortodokse Serbe me rastin e kremteve të tyre fetare, për t'ua uruar ato festa. Një ndërmarrje e tillë me siguri se do t'i zbuste tendosjet në mesin e komuniteteve etnike dhe fetare kosovare. Pranimi i serbëve nga ana e Kosovës është kusht i domosdoshëm për pranimin e Kosovës nga ana e serbëve, dhe pranimi fetar i Kishës Ortodokse Serbe nga fetë e tjera në Kosovë është një hap i rëndësishëm drejt këtij qëllimi.

Mendoj se aktivitetet e propozuara këtu, si dhe të tjera të ngjashme që mund të dalin në të ardhmen, do të ndihmojnë në zbutjen e tendosjeve dhe problemeve ndëretnike, dhe me këtë komuniteti protestant i Kosovës gjithsesi do ta japë një kontribut të jashtëzakonshëm për ta bërë Kosovën një vend më i mirë në të ardhmen.

Ju falemnderit, dhe përshëndetjet më të përzemërta,

Mentor Agani

Zoran Savič, Koordinator i Projekteve
NGO AKTIV
Mitrovicë e Veriut, Kosovë

I dashur Pastor Artur Krasniqi,

Quhem Zoran Savič dhe jam koordinator i projekteve në organizatën joqeveritare Aktiv të Mitrovicës së Veriut. Edhe pse jam lindur në Pulë të Kroacisë, unë në të vërtetë kam jetuar në Mitrovicë për 30 vite dhe jam i përfshirë aktivisht në jetën shoqërore të Kosovës, si përmes punës, ashtu edhe përmes jetës kulturore, duke pasur parasysh se jam edhe muzikant dhe kam marrë pjesë në projekte të shumta ndëretnike me muzikantë të kombësisë shqiptare.

Në të njëjtën kohë, për shumë vite kam punuar si gazetar në portalin Kosova Sever – KoSSev, dhe përmes kësaj pune u njoha edhe më nga afër me situatën politike, të sigurisë dhe atë fetare në Kosovë. Unë edhe sot bashkëpunoj me gazetarë dhe redaktorë të shumtë shqiptarë, si në aspektin e projekteve, ashtu edhe përmes punëve që nuk janë të ndërlidhura me to.

Udhëheqja juaj e Kishës Protestante Ungjillore të Kosovës mund ta promovojë në një masë të madhe harmoninë ndëretnike. Inkurajimi i dialogut dhe bashkëpunimit midis grupeve të ndryshme fetare dhe etnike mund ta ndihmojë kapërcimin e ndarjeve. Ju thërras që t'i mbështesni programet e komunitetit dhe projektet e shërbimeve të përbashkëta që bashkojnë njerëz me prejardhje të ndryshme. Predikimet dhe fjalimet tuaja publike mund t'i theksojnë unitetin, tolerancën dhe respektimin e të gjithëve. Prandaj, në të ardhmen e pres mbështetjen tuaj në organizimin e dialogut ndëretnik dhe të projekteve në shërbim të komunitetit që përfshijnë grupe të ndryshme fetare duke punuar së bashku.

Në këtë frymë, unë shpresoj për një të ardhme ku bashkëjetesa multietnike fetare në Kosovë do të jetë normë. Unë parashoh komunitete ku dallimet fetare merren si anë të forta, jo si burime ndarjeje. Për këtë qëllim, ju mund të përqendrohemi në krijimin e programeve të qëndrueshme që edukojnë për diversitet dhe tolerancë fetare, që mbështesin projekte të përbashkëta të komunitetit, dhe që sigurojnë përfaqësim të barabartë të të gjitha grupeve fetare në qeverisjen lokale.

Duke shikuar në të ardhmen, unë e shoh një Kosovë ku bashkëjetesa multietnike dhe toleranca fetare janë përvetësuar. Takimet e rregullta ndërfitare dhe nismat ndërkulturore mund të nxisin dialog dhe bashkëpunim.

Po e përfundoj këtë letër me një vërejtje shpresëdhënëse, duke parashikuar një të ardhme ku përpjekjet tona të bashkuara do ta kultivojnë një shoqëri vërtet harmonike dhe multietnike në Kosovë. Jam i sigurtë se me përkushtimin tonë të përbashkët, ne mund ta arrijmë një përparim të jashtëzakonshëm drejt këtij qëllimi të çmuar.

Ju falemnderit për kohën dhe konsideratën tuaj.

Zoran Savič